**RAPORT MBI VEZHGIMIN E STANDARDEVE DHE KODEVE (ROSC)**
**Shqipëri**

**KONTABILITET DHE AUDITIM**

**16 qershor, 2006**

**Përmbajtja**


Përmbledhje
I. Hyrje
II. Kuadri Institucional
III. Standardet e Kontabiliteteit të hartuara dhe të vëna në praktikë
IV. Standardet e Auditimit të hartuara dhe të vëna në praktikë
V. Këndvështrim mbi Cilësinë e Raportimit Financiar
VI. Rekomandime në lidhje me Politikat



**Përmbledhje**

**Gjatë periudhës së kalimit në ekonominë e tregut, Shqipëria, në mënyrë të suksesshme arriti të vërë në zbatim një sërë elementesh të rëndësishme të kuadrit institucional dhe statutor/ligjor të raportimit financiar.** Megjithate, ky vlerësim demonstron se Shqipëria duhet të ndërrmarrë hapa të mëtejshme në mënyrë që të arrijë qëllimet e saj për një kuadër të fuqishëm raportimi të krijuar tamam për nevojat qe ka ekonomia Shqiptare dhe ne linje me acquis communautaire te BE-se dhe standartet e praktikat ndërkombëtare. Kuadri ekzistues nuk është gjithmonë konsistent dhe i plotë, dhe burimet e pakta teknike dhe financiare kontribojnë në dobësinë institucionale në disa fusha. Kohet e fundit, raportimi financiar dhe auditimi ndërkombëtar janë bërë më kompleks dhe rigorozë. Gjithashtu kuadri legjislativ i BE-së (acquis communautaire) mbi raportimin financiar dhe auditimin ka evoluar në mënyrë domethënëse në vitet e fundit. Në një mjedis ndërkombëtar rregullator kaq dinamik, kërkesat për raportimin kombëtar financiar mund të dalin lehtësisht nga linja. Pergatitja e një ligji te ri për kontabilitetin në vitin 2004 me objektivën e përmirësimit të cilësisë së raportimit financiar në Shqipëri, ve gjithashtu bazat per një bashkërendim të përmirësuar me acquis communautaire dhe standartet dhe praktikat nderkombetare. Qeveria Shqiptare është plotësisht e vendosur për të ndërmarrë hapat e nevojshme për të mbeshtetur përmirësimin e kuadrit të raportimit financiar në Shqipëri.

**Prezantimi i ligjit të ri për kontabilitetin tregon dëshirën për ndryshim por ende duhet bërë shumë për të zgjidhur mangësitë ekzistuese.** Gjatë këtyre viteve, palë të ndyshme të interesuara kanë bërë një punë të konsiderueshme ad hoc për të përmirësuar gjendjen e raportimit financiar dhe auditimit. Megjithatë, kjo duhet të shoqërohet nga një udhëheqje e qartë e qeverisë për të vendosur tonin për reformë dhe për të koordinuar procesin. Përndryshe, do të vazhdohet të procedohet me mënyrën ad hoc e cila sjell shumë pak përfitime. Për shkak të riorganizimeve të fundit në Ministrinë e Financave, nuk ekziston më një drejtori që përgjigjet për aktivitetet e kontabilitetit dhe auditimit të sektorit privat. Ri krijimi e nje njesie brenda Ministrise, duhet pare me prioritet sepse ajo



Ky raport u përgatit nga një ekip i Bankës Botërore në bazë të konstatimeve të një studimi të kryer në dhjetor të vitit 2005. Ekipi nën drejtimin e Georgine Newman-Alawode (ESCPS) përbëhej nga Frédéric Gielen (ECSPS) dhe Elona Gjika (ECSPS), si dhe nga një grup ekspertësh si Jean-Marc Jacquet, Anne Molyneux dhe Tomasz Wolanin.

do te sherbeje ne te ardhmen si element nismemarreses dhe orientues. Përveç kësaj, krijimi i kapacitetit të duhur institucional dhe forcimi i mëtejshëm i kuadrit statutor/ligjor të raportimit financiar do të jenë shumë të rëndësishme. Lidhjet midis zhvillimit të sektorit privat dhe financiar dhe angazhimi i qeverisë në finalizimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim (MSA) me Bashkimin Evropian (BE), si një hap i parë drejt integrimit Evropian, mund të shërbejnë si forca për ndryshim.

**Është e nevojshme të forcohen kapacitetet institucionale dhe profesionale dhe të pakësohen kërkesat e shumta/tepruara mbi kapacitetin e pakët aktual.** Në mënyrë të veçantë, ka mungesa të theksuara në kapitalin e burimeve njerëzore në shumë fusha me rëndësi, të tilla si hartimi i standardeve të kontabilitetit dhe auditimit, monitorimi dhe përforcimi, si dhe në përgatitjen dhe auditimin e pasqyrave financiare. Shqipëria ka bërë një sërë zgjedhjesh të politikave të cilat i kufizojnë burimet e pakëta institucionale dhe profesionale. Disa nga këto politika përfshijnë: periudha të shkurtra rotacioni të detyrueshëm për disa sektorë; kërkesa për caktimin e dy auditorëve për auditimin e llojeve të caktuara të shoqërive anonime, dhe fushën/spektrin e zbatimit të SNRF-ve në ligjin e ri për kontabilitetin. Një pjesë e mirë e këtyre zgjedhjeve nuk nevojiten domosdoshmërisht për të qenë në përputhje me kuadrin legjislativ të BE-së (*acquis)* dhe për arritjen e një raportimi financiar të një cilësie të lartë. Kështu që, këto zgjedhje të politikave duhet të rishikohen me qëllim që të bëhen më proporcionale në lidhje me kapacitetin institucional dhe profesional. Rritja e kërkesave të raportimit financiar dhe auditimit duhet të mbështetet paralelisht nga forcimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale në mënyrë që të sigurohet dhe të mbahet një raportim financiar i besueshëm dhe cilësor.

**Informacioni financiar i dhënë nga pjesa më e madhe njësive ekonomike të vogla e të mesme nuk konsiderohet i besueshëm.** Kjo shpesh i ngarkohet nivelit të dobët të zbatimit te ligjit dhe deri diku, kapacitetit të kufizuar në vend për të përgatitur dhe audituar pasqyra financiare , si dhe të nivelit të lartë të informalitetit në ekonomomi dhe tendencës së lartë për të shmangur taksat.

**Niveli i perceptuar i transparencës financiare në Shqipëri nuk inkurajon investimin e brendshëm dhe atë të huaj.** Në përgjithësi, nivelet e ulëta të transparencës pengojnë njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme (SME) në marrjen e kredive nga sektori financiar formal. Kjo është e rëndësishme në kontekstin aktual të Shqipërisë, ku afro 92 përqind e të gjitha njësive të biznesit janë njësi të vogla dhe të mesme (SME). Për më tepër, në kushtet e mungesës së një informacioni financiar të besueshëm, aksionerët dhe palët e treta nuk arrijnë të njihen me rendimentin e stafit drejtues, dhe rrjedhimisht pengohet monitorimi mbi bazë tregu i kompanive dhe shpërndarja efektive e burimeve të pakëta.

### *Gjetjet Kryesore*

*Kuadri Rregullator*

- **Kuadri ligjor për raportimin financiar në Shqipëri karakterizohet nga një mungesë e përpuethshmërisë.** Përveç kësaj, ligjet dhe rregulloret e shumta duhet t'iu komunikohen në mënyrë të mjaftueshme njësive ekonomike të cilat duhet t'i

ndjekin dhe zbatojnë ato në mënyrë që të lehtësohet zbatueshmëria e ligjit.

- **Disponueshmëria e informacionit financiar të publikur është shumë e kufizuar në Shqipëri.** Kërkesat aktuale për depozitimin dhe publikimin e pasqyrave financiare nuk janë në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare të kësaj fushe si psh. me kërkesat e Direktivës së Parë, të Katërt dhe të Shtatë të BE-së të Ligjit për Shoqëritë Tregëtare.
- **Ligji i ri i kontabilitetit ka për qëllim të trajtojë shumë nga mangësitë e kërkesave të mëparëshme të kontabilitetit dhe raportimit financiar.** Kërkesat e kontabilitetit në Ligjin e mëparëshëm Për Kontabilitetin, Planin e Përgjithshëm të Kontabilitetit dhe Manualin e Kontabilitetit për Bankat nuk siguronin një cilësi të lartë të raportimit financiar për *njësitë ekonomike me interes publik* në bazë të të cilit përdoruesit e tyre mund të marrin vendime ekonomike. Ato nuk mbulonin çështje kyçe të tilla si: konsolidimi, lizingu (qeraja financiare), kontratat e ndërtimit dhe zhvlerësimi i aktiveve. Ligji i Ri për Kontabilitetin synon të trajtojë këto çështje duke kërkuar përdorimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për *njësitë ekonomike me interes publik* dhe kërkesa të thjeshtuara raportimi për SME-të. Megjithatë, ky seksion i ligjit i cili vendos standardet e aplikueshme të kontabilitetit është shtyrë deri në Janar 2008 për t'i lënë kohë përkthimit të SNRF-ve dhe finalizimit të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), të cilat janë publikuar në Qershor 2006. Rrjedhimisht, gjatë kësaj kohe, është krijuar një boshllëk meqënëse ligji i mëparshëm i kontabilitetit i cili përshkruante "standardet e mëparëshme të kontabilitetit" u shfuqizua dhe hyri në fuqi ligji iri.

*Kapaciteti insitucional dhe profesional*

- **Kuadri vendosës i standardeve të kontabilitetit, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK) ka nevojë për burime të qëndrueshme teknike dhe financiare me qëllim që të përmbushë misionin e tij.** Si një organizëm i pavarur, KKK-ja do të jetë përgjegjëse për të siguruar financimin e vet si dhe aktivitetet e plotësimit të stafit të saj.
- **Nevoja për kualifikim në të gjitha fushat e ekonomisë në lidhje me kontabilitetin, audtimin dhe raportimin financiar është shumë e madhe.** Niveli dhe cilësia e arsimimit dhe kualifikimit në proçesin para dhe pas çertifikimit të kontabilistëve dhe audituesve është i pamjaftueshëm për të plotësuar nevojën ekzistuese për njohuri dhe eksperiencë. Për të përmirësuar këtë gjendje, rregullatorët, stafi drejtues i shoqërive, palët e interesuara, kontabilistët, audituesit dhe arsimtarët duhet të marrin një kualifikim duke filluar nga njohuritë bazë në ato më të avancuarat.

- **Mekanizmat e monitorimit dhe zbatimit nuk janë efikase për të nxitur zbatimin e standardeve të kontabilitetit dhe auditimit.** Me përjashtim të Bankës së Shqipërisë, vihet re një zbatim i kufizuar i standardeve të kontabilitetit nga njësitë e tjera ekonomike. Arsyet e monitorimit dhe aktiviteteve joefikase të zbatimit përfshijnë autoritetin e paqartë ligjor, mungesën e kapacitetit apo autoritetit veprues/operacional, pamundësinë e njësive ekonomike për të plotësuar kërkesat e

duhura për shkak të kapaciteteve të kufizuara, si dhe neglizhencën e autoriteteve në përmbushjen e këtij roli kaq të rëndësishëm. Përveç kësaj, autoriteti për nxitjen e zbatueshmërisë është i shpërndarë në shumë organe rregullatore dhe kjo çon në ulje të mëtejshme të efikasitetit. Për sa i takon monitorimit dhe zbatimit të standardeve të auditimit, ato nuk janë efikase për shkak të mungesës së ekspertizës për kryerjen e kontrolleve të shoqërive audituese sidomos ato që auditojnë *njësitë ekonomike me interes publik*.

*Funksioni i auditimit*

- **Kuadri rregullator i funksionit të auditimit zhvillohet në linjë me direktiven e mëparshme të 8të të BE-së , megjithatë funksioni i auditimit duhet të fitojë më shumë besueshmëri.** Opinioni i auditimit, i dhënë nga auditues lokalë është shumë pak i besueshëm për përdoruesit. Ka shumë pak auditues të cilët kanë njohuri dhe eksperiencë për të kryer auditime të standardeve ndërkombëtare. Cilësia e auditimit përkeqësohet edhe nga kohëzgjatja e shkurtër e auditimit, numri i madh i subjekteve të mesme që i nënshtrohen auditimit statutor (ligjor), dhe evazioni fiskal.

- **Në disa raste audituesit nuk kanë pavarësi nga njësitë ekonomike që auditojnë.** Kjo është një çështje e cila lidhet me mungesën e sistemeve efikase të kontrollit të cilësisë- subjekte të mbikëqyrjes publike-për monitorimin e cilësisë së auditimit dhe përputhjes me kërkesat për pavarësi.

- **Periudhat e shkurtëra të rotacionit të detyrueshëm të shoqërie audituese për sektorin bankar dhe atë të sigurimeve ka çuar në mungesën e konkurrencës dhe kjo mund të sjellë pasoja të paparashikuara në cilësinë e auditimit.** Vetëm katër firma audituese janë të autorizuara për auditimin e bankave dhe dy shoqëri sigurimesh. Prezantimi i një periudhe dy-vjeçare të rotacionit të detyrueshëm të firmës audituese për shoqëritë e sigurimit dhe asaj tre-vjeçare për bankat e kufizon mundësinë për zgjedhjen e shoqërive të auditimit kur kjo kombinohet edhe me kërkesat për pavarësi. Kjo i ekspozon bankat dhe shoqëritë e sigurimit ndaj një situate të vështirë me shumë pak mundësi zgjedhje në kontraktimin e shërbimeve të auditimit.

***Rekomandime mbi politikat***

Nëse të gjitha rekomandimet e dhëna në seksionin VI të këtij raporti janë të rëndësishme, zbatimi i rekomandimeve të përgjithëshme të dhëna më poshtë është i një rëndësie shumë më të madhe për forcimin dhe përmirësimin e kuadrit të raportimit financiar me efekte pozitive në qëndrueshmërinë e sistemit financiar, rritjen ekonomike (duke përfshirë mobilizimin e kapitalit për investim) dhe luftën kundër korrupsionit. Për sa i takon prioritetit, vëmendje e veçantë i duhet kushtuar krijimit të kapaciteteve teknike në të gjitha fushat me qëllim që të përmirësohet situata aktuale, të lehtësohet reforma strategjike dhe holistike dhe të sigurohet qëndrueshmëria. Këto rekomandime do të kontribojnë në rritjen e sektorit privat dhe financiar nëpërmjet:

- Forcimit të arkitekturës financiare shqiptare dhe zvogëlimit të rrezikut të krizave të

tregut financiar dhe impakteve negative që lidhen me të;

- Thithjes së investimeve të huaja direkte apo të portofolit dhe ndihmës në mobilizimin e kursimeve të brendshme/të vendit;
- Lehtësimit të marrjes së kredive nga huamarrësit e koorporatave të vogla nga sektori financiar duke zvogëluar pengesën e informacioneve të shumta dhe kostove të huamarrjes, dhe
- Ndihmës ndaj investuesve në kompanitë e mëdha në vlerësimin e potencialit/vizionit të korporatave dhe në marrjen e vendimeve me anë të votimit, të cilat do të çojnë në një kosto më të ulët të kapitalit dhe një shpërndarje më të mirë të burimeve. Raportimi financiar është gjithashtu një mënyrë/formë monitorimi mbi bazë tregu i shoqërive e cila bën të mundur që aksionerët dhe publiku në përgjithësi të njihen me performancën e stafit drejtues, duke ndikuar kështu në sjelljen e tyre.

| ***<u>Veprime për t'u ndërmarrë</u>*** | ***<u>Afati për zbatim</u>*** |
|---|---|
| • Forcimi i kuadrit statutor që drejton kontabilitetin, auditimin dhe raportimin financiar. | brenda 18 muajsh |
| • Forcimi i strukturave *të qëndrueshme* për hartimin e standardeve cilësore të kontabilitetit dhe auditimit dhe udhëzueve mbi zbatimin e tyre. | 1 deri në 3 vjet |
| • Krijimi i mekanizmave të monitorimit sistematik dhe zbatimit për të siguruar përputhshmërinë me standardet e kontabilitetit dhe auditimit. | brenda 18 muajsh |
| • Përmirësimi i cilësisë së punës së kontabilistëve dhe audituesve nëpërmjet nismave për zhvillimin e gjërë të kapaciteteve të profesionistëve aktualë. | 1 deri në 7 vjet |
| • Rritja e numrit të profesionistëve kontabilistë dhe auditues të aftë për përgatitjen e pasqyrave financiare të një cilësie të lartë dhe për kryerjen e auditimeve cilësore. Kjo do të përfshinte sigurimin e stimujve për të tërhequr në profesion studentët që mbarojnë me rezultate shumë të larta dhe rritjen e shkallës së njohjes së kualifikimeve. | 1 deri në 7 vjet |
| | 1 deri në 7 vjet |

# I. HYRJE

1. Ky vlerësim i praktikave të kontabilitetit dhe auditimit në Shqipëri është pjesë e një nisme të përbashkët të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) për të përgatitur Raporte mbi Vëzhgimin e Standardeve dhe Kodeve (RVSC). Vlerësimi përqëndrohet në pikat e forta dhe të dobëta të gjendjes së kontabilitetit dhe auditimit të cilat ndikojnë në cilësinë e raportimit financiar të korporatave dhe përfshin një rishikim si të kërkesave të detyrueshme (ligjore) ashtu edhe të praktikës aktuale. Në këtë vlerësim janë përdorur Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)[1] dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA)[2] si modele referimi dhe janë marrë shembull përvojat ndërkombëtare dhe praktikat më të mira në fushën e rregullimit të kontabilitetit dhe auditimit. Për vende si Shqipëria që aspirojnë të hyjnë në Bashkimin Evropian (BE), vlerësimi lidhet gjithashtu edhe me kërkesat e legjislacionit të BE-së, (*acquis communautaire*). Raporti ndonjëherë merr pozicion të tillë i cili shkon përtej *acquis* (p.sh. rekomandon përdorimin e SNRF-ve për njësitë ekonomike më interes publik[3]). Pozicione të tilla janë të identifikuara qartë.

2. **Që nga koha e kalimit në ekonominë e tregut, Shqipëria ka pasur vazhdimisht një rritje të lartë të GDP-së vjetore, duke shkuar mesatarisht në 5.7 përqind gjatë periudhës 2000-2005.** Pas 46 vjetësh centralizimi dhe ekonomie të izoluar, periudha e tranzicionit pothuajse u shkatërrua në vitin 1997 nga një gjendje e rënduar makroekonomike. Ndonëse vendi e ka kapërcyer tashmë krizën, një pjesë e madhe e popullsisë jeton akoma në varfëri dhe treguesit mbi ndjekjen e arsimit vazhdojnë të mbeten të ulëta. Kjo është shqetësuese për faktin se niveli i arsimimit lidhet drejtpërdrejtë me cilësinë dhe disponueshmërinë e forcës punëtore të kualifikuar dhe të të aftë për të përmbushur nevojat e sektorit financiar dhe privat në rritje.

3. **Afro 92 përqind e 35, 000 njësive ekonomike në Shqipëri janë njësi të vogla, me afro një deri në katër punonjës.** Kërkesat për raportimin financiar për këto njësi ekonomike të vogla dhe gjithashtu për njësi ekonomike të mesme, janë të rëndësishme për shkak të impaktit aktual dhe potencial mbi ndërmjetësimin bankar, grumbullimin e taksave dhe disiplinës financiare. Është e nevojshme të arrihet një ekuilibër mes përfitimeve që sjell informacioni bazë financiar i cili ndihmon në marrjen e vendimeve ekonomike dhe biznesit, dhe kostot e kërkesave të mbingarkuara për raportim.

4. **Burimi kryesor i financimit për njësitë ekonomike është joformal, dhe kryesisht nga fonde të burimeve familjare dhe kjo ndikon në nivelet e shpjegimeve**

[1] Në këtë raport, termi SNRF i referohet si Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ashtu edhe Standardeve të nxjerra nga Bordi i Komitetit për Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe çdo Interpretim të aplikueshëm të Komitetit të Interpretimeve të Raportimeve Financiare Ndërkombëtare (KIPFN).

[2] Në këtë raport, termi SNA i referohet Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe praktikave të zhvilluara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (BSNA) i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK).

[3] Në këtë raport, njësi ekonomike me interes publik nënkupton atë njësi ekonomike që për shkak të natyrës si biznesit, madhësisë, numrit të punonjësve dhe palët e interesuara në të, zgjojnë interes të publikut të përgjithshëm. Të tilla njësi janë bankat, shoqëritë e sigurimeve, fondet e investimeve, fondet e pensioneve, shoqëritë e listuara duke përfshirë dhe njësitë ekonomike shtetërore të mëdha.

**dhe paraqitjes së pasqyrave financiare.** Shqipëria ka nivelin më të ulët të kredidhënies bankare për sektorin privat si pjesë e GDP në rajon ndonëse ai ka pasur rritje të ndjeshme vit pas viti nga nivelet bazë. Burimet e financimit dhe përqëndrimi i pronësisë ndikon mbi nevojat për informacion të pronarëve ndaj investuesve, kërkesat për shpjegime dhe strukturat qeverisëse të korporatës [modelet "insider" (stafi drejtues vjen nga brenda njësisë) kundrejt "outsider"(stafi drejtues është marrë nga jashtë njësisë)]. Në Shqipëri, mungesa e një tregu aktiv kapitali dhe nivelet aktuale kredive të bankave për sektorin privat shpjegojnë kërkesën e përhapur për transparencë financiare.

5. **Sektori bankar në Shqipëri përfaqëson 90 përqind të sektorit financiar.**[4] Ndërmjetësimi financiar i kufizuar i dikurshëm po rritet me ritme të shpejta dhe pjesa më e madhe e portofolit të huave të dhëna është në monedhë të huaj. Pozicioni i rëndësishëm i këmbimit valutor dhe zgjerimi i shpejtë i kredive ka nevojë për një kuadër raportimi financiar më rigoroz i cili do të ndihmonte në rregjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve (mjeteve) dhe pasiveve (detyrimeve) të bankave dhe do të kontrollonte ekspozimin e bankave dhe huamarrësve ndaj rrezikut që mbartin këmbimet valutore.

6. **Aktualisht, sektori financiar jobankar është i kufizuar por zgjerimi i tij duhet të shoqërohet nga një reformë institucionale.** Duke u përqëndruar në Detyrimin e Palës së Tretë (TPL), shoqëritë e sigurimeve kanë kombinuar primet duke përfaqësuar 0.5 përqind të GDP-së. Sot, ekziston një referencë historike teknike e kufizuar si dhe ekspertizë e kufizuar në kontabilitetin dhe auditimin e fushës së sigurimeve. Aktualisht ekziston vetëm një shoqëri lizingu por me ligjin e ri për lizingun (qiranë financiare) dhe kërkesën për burime të tjera financimi, pritet që ky sektor të rritet ndjeshëm. Momentalisht, nuk ka shoqëri të listuara në bursë. Megjithatë, me futjen e ligjit të ri mbi Qiramarrjen dhe efektshmërinë e Ligjit mbi Autoritetin Mbikqyrës të Sigurimeve (Mars 2006) dhe bazuar mbi kërkesën për burime të tjera financimi, pritet që ky sector të zhvillohet ndjeshëm.

7. **Njësitë ekonomike shtetërore (NSH) luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit, sidomos në sektorët e energjisë dhe komunikimit dhe industrinë e përpunimit të naftës.** NSH-të, si disa prej njësive ekonomike më të mëdha në Shqipëri janë me rëndësi si *njësi me interes publik*, dhe si kandidate të mundëshme për t'u privatizuar në të ardhmen. Për këto njësi ekonomike duhet kërkuar transparencë financiare dhe shpjegime të mjaftueshme financiare me qëllim që të mundësohet një qeverisje e mirë, disiplinë fiskale dhe shpërndarje optimale e burimeve të pakëta

8. **Ky raport merr në konsideratë të gjithë aspektet e sipër-përmendura dhe jep një përmbledhje të arsyeve kryesore pse Shqipëria duhet të vazhdojë me reformat e ndërmarra në kontabilitet dhe auditim por në një mënyrë më të plotë dhe sistematike.** Në këtë kontekst, raporti jep rekomandime mbi politikat për forcimin e cilësisë së raportimit financiar të korporatave. Parashikohet që një Komitet Drejtues Kombëtar (KDK) do të hartojë një Strategji për Vendin me një Plan të Detajuar Veprimi

[4] Shih Vlerësimin e Bankës Botërore për Sektorin Financiar në Shqipëri, shtator 2005.

në bazë të rekomandimeve të dhëna në këtë raport, si një hap i parë në procesin e reformës.[5]

## II. KUADRI INSTITUCIONAL

### A. Kuadri statutor (ligjor)[6]

9. **Kuadri ligjor i raportimit financiar ka mungesë qëndrueshmërie.** Ligjet nuk janë në harmoni me njëri-tjetrin dhe shpesh bazohen në modele të ndryshme ligjore. Për shembull, një nga ligjet kryesore për sektorin bankar bazohet në burimet e të drejtave anglosaksone kurse Ligji Për Kontabilitetin dhe Ligji Për Shoqëritë Tregëtare bazohen në një model kontinental Evropian. Përdorimi i këtyre modeleve të ndryshme mund të shkaktojë mospërputhshmëri në sistem. Kjo sjell gjithashtu vështirësi edhe në interpretimin, zbatimin dhe arritjen e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

10. **Identiteti ligjor i të gjitha njësive ekonomike në Shqipëri përcaktohet në Ligjin mbi Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë (këtej e tutje i referuar si "Kodi Civil") që daton në korrik 1994.** Ky ligj përcakton natyrën e njësive tregëtare si subjekte ligjore private. Po kështu, ligji përshkruan detyrimet e subjekteve ligjore, krijimin dhe përmbajtjen e detyrimeve dhe bazat ligjore të marrëdhënieve të njësisë (stafi drejtues me pronarët).

11. **Krijimi dhe rregullimi i njësive të biznesit në Shqipëri udhëhiqet nga Ligji Për Shoqëritë Tregëtare, i cili është amenduar për herë të fundit në vitin 1995.** Në këtë ligj janë bërë plotësime me ligje të tjera, rregullore dhe udhëzime të ndryshme specifike të sektorit. Përdorimi i udhëzimeve, edhe pse i dobishëm për zbatim, mund të shkaktojë vështirësi kur ka ndryshime të shpeshta në to dhe shoqëritë nuk arrijnë ti zbatojnë kërkesat e kohës.

12. **Me qëllim që të trajtohen mangësitë e ligjit të mëparëshëm të kontabilitetit, kohët e fundit u hartua një Ligji i Ri Për Kontabilitetin.** Ligji Për Kontabilitetin (1993), i plotësuar nga Plani i Përgjithshëm Kontabël i cili jepte udhëzime të hollësishme duke përfshirë një plan llogarish, përshkruante kërkesat e zbatueshme të kontabilitetit dhe raportimit financiar për të gjithë njësitë e biznesit në Shqipëri. Ky ligj u shfuqizua me hyrjen në fuqi të Ligjit të Ri Për Kontabilitetin dhe Paqyrat Financiare (këtej e tutje referuar si "Ligji për Kontabilitetin (2004") më 1 janar 2006. Sipas ligjit të ri kërkohet përdorimi i SNRF-ve për përgatitjen e pasqyrave financiare ligjore dhe të konsoliduara të njësive ekonomike me interes publik dhe përdorimi i SKK-ve për përgatitjen e të gjitha pasqyrave të tjera financiare. Megjithatë, hyrja në fuqi e nenit 4 të ligjit të ri, i cili përcakton standardet e zbatueshme të kontabilitetit është shtyrë për në

[5] Në fillim të vlerësimit, Ministria e Financës ngriti një Komitet Drejtues Kombëtar të përbërë nga përfaqësues nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit KKK, LPKM, SHKFSH, Komisioni Shqiptar për Letrat me Vlerë, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financës, Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve në Shqipëri, Kontrolli i Lartë i Shtetit, përfaqësues nga shoqëritë audituese për të shqyrtuar vlerësimin dhe zbatuar rekomandimet.

[6] Ky raport jep një përmbledhje të parimeve ligjore që zbatohen për kontabilitetin, auditimin dhe raportimin financiar dhe synon vetëm të bëjë një prezantim të çështjeve. Raporti nuk është një interpretim i plotë i ligjit dhe nuk duhet të shihet si këshillues ligjor për lexuesit.

datën 1 janar 2008 për shkak të problemeve me përkthimin e SNRF-ve dhe finalizimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (NAS). Për rrjedhojë, shoqëritë do të vazhdojnë të zbatojnë standardet e Planit të Përgjithshëm të Kontabilitetit, i cili aktualisht nuk ka asnjë bazë ligjore.

13. **Në Ligjin Për Shoqëritë Tregëtare jepen katër tipe kryesore njësish biznesi.** Tipet e njësive ekonomike të rregulluara nga Ligji Për Shoqëritë Tregëtare janë: 1) partneritetet e përgjithshme, 2) partneritetet e kufizuara, 3) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar (ShPK-të) dhe 4) shoqëritë anonime (ShA-të). Ky raport përqëndrohet kryesisht në njësitë ekonomike ku aksionerët kanë përgjegjësi të kufizuar, pra, ShPK -të dhe ShA-të.

- *Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar* (ShPK-të) krijohen nga një (në rastin e tregëtarëve të vetëm) ose disa aksionerë të cilët mbajnë përgjegjësi për humbjet vetëm deri në kufirin e kontributit të tyre në minimumin e kapitalit të kërkuar. Këtyre shoqërive nuk iu lejohet të lëshojnë apo garantojnë lëshimin e letrave me vlerë. Ky kufizim përgjegjësie deri në minimumin e kapitalit të kërkuar është në kundërshtim me marrëveshjet afat-gjata të shoqërive, të cilat përcaktojnë se kontributet e mëpasëshme në kapital i nënshtrohen parimeve të njëjta me kontributin fillestar në kapital. Kjo është problematike për faktin se shoqëritë e auditimit mund të krijohen vetëm si SHPK dhe kjo bën që ato të kenë detyrime civile ndaj klientëve të tyre dhe palëve të treta në rast se dështojnë në plotësimin e detyrave të tyre siç duhet. SHPK-të zakonisht kanë një strukturë menaxhimi me një shkallë (bordi i drejtuesve) dhe drejtuesit kanë përgjegjësi të përbashkët ose të ndarë ndaj shoqërisë apo palëve të treta në rast të shkeljes së ligjeve.
- *Shoqëritë anonime* (ShA) krijohen nga aksionerë të cilët mbajnë përgjegjësi për humbje deri në kufirin e kontributit të tyre në kapitalin fillestar (shih diskutimin e mësipërm në lidhje me këtë çështje). Ndryshimi në kapitalin fillestar minimal dhe pronësia e kapitalit bën dallimin mes tre kategorive kryesore të Shoqërive Anonime (ShA): ShA të palistuara në bursë, SHA të listuara dhe Ndërmarrje Shtetërore (e zotëruar plotësisht nga shteti ose nga një agjensi publike). Bankat dhe shoqëritë e sigurimit duhet të krijohen si SHA sipas ligjit të bankave dhe ligjit pët shoqëritë e sigurimit. Të gjitha SHA-të me përjashtim të bankave duhet të kenë një sistem bordi të dyzuar. Bordi mbikëqyrës vendos dhe ushtron një mbikëqyrje të vazhdueshme mbi bordin e drejtuesve.

**14. Ligji i mëparëshëm Për Kontabilitetin dhe Ligji i Ri Për Kontabilitetin (2004) përcaktojnë se tek të gjitha njësitë ekonomike, përfaqësuesit ligjorë të njësisë mbajnë përgjegjësi për saktësinë e pasqyrave financiare.** Nuk ka të dhëna të disponueshme që tregojnë se si monitorohet përputhshmëria dhe zbatimi por niveli i ulët i plotësimit të kërkesave të kontabilitetit dhe raportimit financiar (referohuni Seksionit III) tregon se monitorimi dhe zbatimi kanë nevojë për përmirësim të konsiderueshëm. Ligji për Kontabilitetin (2004) e shtrin përgjegjësinë për saktësinë e pasqyrave financiare deri tek bordi i mbikëqyrjes por nuk përcakton nëse përgjegjesia është e përbashkët apo e ndarë, ose çfarë sanksionesh aplikohen për raste mospërputhjesh/shkeljesh. Sidoqoftë, nxitja përputhshmërisë me qëllim që të mbrohen përdoruesit e pasqyrave financiare, do të

kërkonte një sistem ligjor me kapacitet dhe gatishmëri për të ndëshkuar rastet e mospërputhjes me kërkesat ligjore të raportimit financiar

**15. Ligji Për Shoqëritë Tregëtare përcakton detyrimet civile të audituesve, anëtarëve të bordit të drejtuesve dhe bordit mbikëqyrës ndaj shoqërisë dhe palëve të treta në lidhje me raportimin fianciar dhe auditimin por mbeten akoma të patestuara.** Audituesit mbajnë përgjegjësi ndaj shoqërisë dhe palëve të treta për dëmet e ardhura nga gabimet e tyre dhe neglizhenca në kryerjen e auditimit. Megjithatë, në kontratat e tyre me shoqëritë, disa shoqëri auditimi kanë "kufizuar" përgjegjësinë e tyre ndaj shoqërisë me një shumëfishim të çmimit të auditimi të tyre.[7] Anëtarët e bordit të drejtuesve mbajnë përgjegjësi në mënyrë individuale apo të përbashkët ndaj shoqërisë ose palëve të treta për shkeljen e ligjeve të zbatueshme dhe për gabimet e tyre në drejtimin e shoqërisë. Ndërsa, anëtarët e bordit mbikëqyrës mbajnë përgjegjësi vetëm për gabimet e tyre personale. Për më tepër, audituesit dhe bordi mbikëqyrës nuk mbajnë përgjegjësi për veprimet e menaxhimit nëse nuk kanë pasur dijeni për to dhe nuk i kanë raportuar tek palët e interesuara. Ekipi i ROSC nuk mundi të identifikonte ndonjë rast ku është ndërmarrë me sukses ndonjë masë (veprim) ligjore ndaj audituesve, bordit të drejtuesve apo bordit mbikëqyrës.

**16. Në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, Ligji për Shoqëritë Tregëtare, kërkon që aksionerët të miratojnë pasqyrat financiare të njësisë ligjore.** Anëtarët e bordit të drejtuesve duhet të paraqesin për miratim pasqyrat financiare të njësisë (të audituara në rastet kur kërkohet) në asamblenë e përgjithshme të aksionerëve brenda gjashtë muajve të fundit të vitit financiar. Në rastin e SHA-ve aksionerët miratojnë gjithashtu edhe pasqyrat financiare të konsoliduara. E drejta e aksionerëve për të miratuar pasqyrat financiare të njësisë ligjore është e rëndësishme pasi lejon "pronarët" e shoqërisë të kontrollojnë performancën e stafit drejtues dhe administrimin/menaxhimin e burimeve të njësisë ekonomike (shoqërisë).

[7] Nuk ka ndonjë të ligj të shprehur për këtë në Kodin Civil apo Ligjin për Shoqëritë Tregëtare dhe kufij të tillë janë ende të patestuara në Shqipëri.

**17. Kërkesat aktuale të kontabilitetit jepen në Ligjin Për Kontabilitetin (2004), Planin e Përgjithshëm Kontabël, dhe ligjet specifike të sektorit siç përshkruhen në Tabelën 1 më poshtë:**

| **Lloji i njësisë ekonomike** | **Pasqyrat financiare të njësisë ligjore** | **Pasqyrat financiare të konsoliduara** | **Auditimi** | **Publikimi** |
|---|---|---|---|---|
| **SME-të (duke përfshirë bizneset me një pronësi të vetme dhe ortakëri të kufizuara)** | E paspecifikuar me shtyrjen e nenit 4 të ligjit të ri për kontabilitetin (2004) | Asnjë | Asnjë | Po |
| **SHPK-të** | Plani i Përgjithshëm i Kontabilitetit dhe Ligji për Kontabilitetin (2004) | Kërkohet sipas Ligjit Për Kontabilitetin | Kërkohet sipas Ligjit Për Shoqëritë Tregtare nëse kalohen kufij të caktuar | Po |
| **SHA-të** | Njësoj si SHPK-të | Njësoj si SHPK-të | Kërkohet nga Ligji Për Shoqëritë Tregëtare | Po |
| **Bankat** | Kërkesa të detajuara të kontabilitetit në Manualin e Kontabilitetit për Bankat, Ligji Për Kontabilitetin (2004) | Ligji Për Bankat | Kërkohet nga Ligji për Shoqëritë Tregëtare | Po |
| **Shoqëritë e Sigurimeve** | Plani i përgjithsëm i Kontabilitetit, Ligji për Sigurimet dhe Ligji Për Kontabilitetin (2004) | Njësoj si SHPK-të | Kërkohet nga Ligji për Shoqëritë Tregëtare | Po |
| **NSH** | Njësoj si SHPK-të | Njësoj si SHPK-të | Kërkohet nga ligji për Shoqëritë Tregëtare | Po |

*Tabelat 1: Kerkesat aktuale te kontabilitetit, auditimit dhe raportimit financiar*

Ligji i ri Për Kontabilitetin (2004) kërkon që të gjitha shoqëritë e listuara (asnjë në Shqipëri), shoqëritë e mëdha të palistuara (ende të papërcaktuar në legjislacionin dytësor), dhe institucionet financiare duhet të përgatisin pasyrat e tyre financiare të njësisë ligjore dhe ato të konsoliduara sipas SNRF-ve. Të gjithë njësitë e tjera duhet të përgatisin pasqyrat e tyre financiare në përputhje me SKK-të të hartuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe miratuar nga Ministri i Financës. Fusha e zbatimit të SNRF-ve është bërë më e proporcionuar me Ligjin e ri të Kontabilitetit (2004), megjithatë shkon disi përtej përdorimit të kërkuar të SNRF-së nën kuadrin ligjor të BE-së dhe mund të sjellë kërkesa të mëdha mbi burimet e pakëta. Me shtyrjen e hyrjes në fuqi të nenit 4 të ligjit të ri për kontabilitetin (2004) lind nevoja për një qartësi më të madhe dhe udhëzime mbi kërkesat e aplikueshme të kontabilitetit gjatë dy viteve të ardhëshme sidomos për standardet e kontabilitetit që do të përdoren nga SME-të, korporata të tjera të mëdha të sektorit,dhe sektori i sigurimeve

**18. Deri sa Manuali i Kontablitetit Për Bankat të azhornohet dhe të vihet në linjë me SNRF-të, bankat do të ndeshen me kërkesa konfliktuale për raportimin financiar kur Ligji Për Kontabilitetin (2004) të hyjë në fuqi.** Ligji Për Bankat ende kërkon që ato të përgatisin statutet e tyre individuale dhe pasqyrat financiare të konsoliduara në përputhje me Manualin e Kontabilitetit për Bankat i cili është bazuar në versionin e SNRF-ve të vitit 1998. Manuali nuk është azhornuar që nga publikimi i tij dhe nuk përmban shpjegime të rëndësishme që lidhen me instrumentet financiarë (referojuni seksionit III).

**19. Ligji Për Bankat kërkon që ato të përgatisin pasqyra financiare të konsoliduara por nuk ka standarde konsolidimi.** Manuali i Kontabilitetit për Bankat nuk përshkruan standarde për përgatitjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara. Përveç kësaj, përkufizimet e "njësisë kontrolluese" në Ligjin për Bankat nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në SNRF ose Direktivën e Shtatë të BE-së në lidhje me Ligjin për Shoqëritë Tregëtare, duke çuar kështu në pasqyra financiare të konsoliduara të cilat nuk përfshijnë të gjitha njësitë brenda grupit dhe japin informacion financiar të paplotë.

**20. Ligji Për Shoqëritë Tregëtare përcakton kërkesa të auditimit vjetor për të gjitha njësitë ekonomile përveç njësive të vogla, të cilat nuk kalojnë kufij të caktuar siç tregohet në tabelën 2:**

| ***Tipi i njësisë*** | ***Kërkesat e detyrueshme të auditimit*** |
|---|---|
| **SHPK** | Duhet të caktojnë një auditues nëse kapërcejnë dy nga tre kriteret e mëposhtëme:<br>1) Aktivet e bilancit në 6 milion Lekë (ekivalente me afro 48,618 EUR)<br>2) Shitjet vjetore prej 12 milion Lekë (ekuivalente me afro 97,236 EUR)<br>3) Mesatarisht 10 punonjës |
| **SHA-të e listuara** | Duhet të caktojnë dy auditues |
| **SHA-të e palisutuara me një kapital me më pak se 20 milion Lekë, duke përfshirë dhe NSH-të** | Duhet të caktojnë një auditues |
| **SHA-të e palistuara me një kapital me më shumë se 20 milion Lekë, duke përfshirë dhe NSH-të** | Duhet të caktojnë dy auditues |
| **Bankat** | Duhet të caktojnë një ose dy auditues (shih më sipër) |
| **Shoqëritë e Sigurimeve** | Duhet të caktojnë një ose dy auditues (shih më sipër) |

*Tabela 2: Kërkesa për auditim vjetor*

**21. Nuk ekziston ndonjë legjislacion specifik që përcakton  se cilat standarde të auditimit duhet të zbatohen për auditimet ligjore. Megjithatë,** organi i profesionistëve të auditimit, si i vetmi organ përgjegjës për zhvillimin e standarteve te auditimit, ka përcaktuar deytrimin për zbatimin e SNA-ve (standardeve ndërkombëtare të auditimit) për anëtarët e tij, dhe këto janë standarde të cilat audituesit në Shqipëri pretendojnë se i zbatojnë/plotësojnë.

**22. Përjashtimi nga auditimi i disa shoqërive të palistuara është në përputhje me Direktivën e Katërt të BE-së të Ligjit Për Shqëritë Tregëtare.** Megjithatë, kufijtë (shih tabelën 2 më sipër) janë shumë të ulëta në krahasim me limitet e caktuara në Direktivë, kështu që vetëm njësi ekonomike të vogla i nënshtrohen kërkesave për auditim. Ndërsa Shqipëria si shumë vende të vogëla, anëtare të BE-së dëshiron të përdorë kufij më të ulët, duhet të mbahet parasysh që këta kufij shumë të ulët do të vendosin një detyrim për auditim mbi shoqëri shumë të vogëla, gjë që mund të çojë në një cilësi jo të mirë auditimi. Kufijtë vendosen më së miri, vetëm pas një studimi të hollësishëm të strukturës së biznesit për të identifikuar faktorët e kërkesës dhe ofertës të cilat do të përcaktojnë një kufi të përshtatshëm meqënëse nuk mund të rregullohet efektivisht një treg i panjohur në vend. Vetëm atëherë përfitimet e vendosjes së këtyre kufijve të ulëta si kultivimi i një "kulture auditimi" mund të vlerësohen kundrejt cilësisë së ulët të auditimit që vjen nga një kërkesë e tillë.

**23. Ka pak të dhëna që tregojnë se kërkesa aktuale për auditime të përbashkëta kontribon në rritjen e cilësisë së auditimit në Shqipëri dhe në praktikë kjo nuk zbatohet.** Shumë nga shoqëritë e shqyrtuara në Seksionin III e kalojnë kërkesën e kapitalit (të diskutuar në paragrafin 20 më sipër) por nuk kanë caktuar/zgjedhur auditues të përbashkët.  Justifikimet e pretenduara të auditimeve të përbashkëta janë se ato sigurojnë auditim shtesë mbi cilësinë e auditimit dhe bën të mundur që shoqëritë audituese të një niveli jo shumë të lartë të përfitojnë eksperiencë duke punuar me shoqëritë më të mira audituese. Në konteksin aktual të Shqipërisë, kjo kërkesë ngre një sërë çështjesh praktike për shkak të burimeve të kufizuara njerëzore. Duke marrë parasysh shkallën e kapacitetit teknik në shoqëritë audituese lokale, mundësia që një shoqëri audituese e një shkalle të lartë të pranojë të kryejë një auditim të përbashkët me një shoqëri audituese lokale dhe të ketë besim në punën e kësaj shoqërie është shumë e vogël.  Përveç kësaj, kjo kërkesë i shtohet edhe çështjeve që vijnë nga rotacioni i detyrueshëm i shoqërive audituese siç është diskutuar në paragrafin 25 më poshtë dhe mungesa e kapacitetit të auditimit siç diskutohet në paragrafin 33 më poshtë.

**24. Banka e Shqipërisë aprovon audituesin ligjor i cili do të kryejë auditimin ligjor (statutor) të pasqyrave financiare të bankave.** Për shkak të kapacitetit të ulët të shoqërive audituese ky proces para-aprovimi është një monitorim paraprak (*ex ante)* i mirë i cilësisë së bankave. Megjithatë, aprovimi bazohet kryesisht në kriteret administrative dhe eksperiencë të shoqërisë audituese prej minimumi pesë vjetësh. Kjo kërkesë për eksperiencë ka përjashtuar nga auditimi i bankave të gjitha shoqëritë audituese lokale duke i lënë bankave mundësinë për të zgjedhur vetëm ato shoqëri audituese lokale të cilat   janë anëtare të rrjeteve të shoqërive audituese ndërkombëtare aktive në tregun e auditimit në

Shqipëri. Rregullatori i sigurimeve ka paraqitur kohët e fundit kërkesa të ngjashme për shoqëritë e sigurimeve.

**25. Rregullatorët e bankave dhe të sigurimeve kufizojnë ashpër bankat dhe shoqëritë e sigurimeve në zgjedhjen e audituesve për shkak të periudhave të shkurtra të specifikuara për rotacionin e detyrueshëm të shoqërive audituese.** Banka e Shqipërisë kërkon një rotacionin tre-vjeçar të detyrueshëm të shoqërisë audituese ndërsa Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve në Shqipëri kërkon një rotacion të tillë të detyrueshëm çdo dy vjet. Kjo kërkesë është më e fortë se ajo e kuadrit ligjor të BE-së dhe mund të mos e arrijë synimin e pavarësisë së audituesve duke iu lënë njësive ekonomike një mundësi të kufizuar për zgjedhjen e shoqërisë audituese. Nga katër shoqëritë audituese të cilat aktualisht lejohen të auditojnë banka dhe shoqëri sigurimesh, vetëm dy prej tyre janë aktive në treg. Kështu që, duke përdorur një auditues për një periudhë kohe maksimale, këto njësi do të duhet të zgjedhin audituesin tjetër në treg. Kjo bën që bankat dhe shoqëritë e sigurimevetë mos kenë mundësi zgjedhjeje të shërbimeve të auditimit dhe kufizon konkurrencën në tregun e auditimit pa e konsideruar fare mundësinë për auditues të përbashkët.

**26. Ligji i ri për Kontabilitetin (2004) thjeshton kërkesat për depozitim për të gjitha njësitë.** Në ligjin e mëparëshëm të kontabilitetit, kishte mospërputhshmëri të ndjeshme me kërkesat për depozitim dhe publikim dhe si rezultat informacioni financiar nuk ishte i disponueshëm në Shqipëri. Ligji i ri i kontabilitetit kërkon që të gjitha njësitë të depozitojnë pasqyrat e tyre financiare ligjore dhe ato të konsoliduara (të audituara kur duhet) pranë gjykatave përkatëse (gjykatat e rrethit) një muaj pas miratimit të tyre në asamblenë e aksionerëve. Ky është një përmirësim në krahasim me ligjin e mëparëshëm i cili përcaktonte afate të ndryshme për depozitim për njësitë e biznesit dhe gjithashtu edhe për pasqyrat financiare të njësisë ligjore dhe ato të konsoliduara. Megjithatë, asnjë nga gjykatat e rrethit nuk ka kapacitetin fizik, mjetet apo stafin e duhur për plotësimin e kësaj kërkese. Në këto kushte, pa u zgjidhur problemi i kapacitetit,zbatueshmëria e kërkesave për depozitim ose monitorimi i tyre do të jetë i kufizuar, pra do të ekzistojnë të njëjtat vështirësi të hasura nga organi shtetëror i statistikave si edhe në ligjin e mëparëshëm.

**27. Nuk ka ndonjë kërkesë për të bërë publike pasqyrat financiare të audituara të njësisë ligjore apo pasqyrat financiare të konsoliduara.** SHPK-të, SHA-të dhe të gjitha shoqëritë e listuara duhet të publikonin pasqyrat e tyre finaciare, së bashku me opinionin e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, 30 ditë pas aprovimit të aksionerëve. Të gjitha njësitë/shoqëritë duhet të vinin në dispozicion të punonjësve dhe aksionerëve të tyre informacionin e paraqitur në pasqyrat financiare por nuk ishte e qartë nëse duhej të vihej në dispozicion i gjithë informacioni i pasqyrave financiare apo vetëm pjesë të veçanta të tij. Ligji i ri për kontabilitetin nuk shprehet mbi publikimin e pasqyrave financiare të audituara apo të paaudituara nga njësitë e biznesit dhe kjo tregon një hap prapa në krahasim me ligjin e mëparshëm.

**28. Bankat i respektojnë kërkesat për depozitim të caktuara si të detyrueshme nga Banka e Shqipërisë.** Pas miratimit të pasqyrave financiare të audituara në asamblenë e aksionerëve, sipas ligjit, kërkohet që bankat të publikojnë pasqyrat e tyre financiare së bashku me raportin e audituesit në buletinin e tyre zyrtar (raporti vjetor). Pasqyrat financiare të njësisë ligjore të disa bankave publikohen edhe në faqet e tyre të internetit.

Bankat e tjera vënë në dispozicion të publikut të përgjithshëm vetëm pasqyrat financiare të audituara jo-ligjore të përgatitura në përputhje me SNRF-të, dhe të publikuara në gjuhën angleze. Për shkak të disponueshmërisë së kufizuar të pasqyrave financiare ligjore të audituara të bankave, është shumë e vështirë që përdoruesit publik të bëjnë krahasimin e cilësisë së pasqyrave financiare dhe të vlerësojnë gjendjen financiare të një banke të caktuar.

**29. Shoqëritë e sigurimeve në përgjithësi nuk i plotësojnë kërkesat për depozitim dhe publikim të përcaktuara në Ligj.** Kuadri rregullator për shoqëritë e sigurimit u azhornua kohët e fundit me kalimin e një Ligji të Ri për Sigurimet dhe rregulloret plotësuese të nxjerrë nga AMS në vitin 2004. Shoqëritë e sigurimit duhet të paraqesin pranë AMS pasqyrat e tyre financiare të njësisë ligjore, të cilat përfshijnë bilancin, llogarinë e të ardhurave dhe shpenzimeve, raportet teknike të kujdesit dhe opinionin e audituesit, brenda datës 31 mars. Këto pasqyra financiare dhe raporti i audituesit duhet të publikohen në një nga publikimet financiare periodike të shoqërisë brenda datës 30 qershor. Publikimi financiar periodik është akoma i papërcaktuar dhe nuk ka fakte.dokumenta që tregojnë publikimin e pasqyrave financiare të shoqërive të sigurimeve . Në praktikë, pasqyrat financiare nuk paraqiten gjitmonë pranë AMS në kohën e duhur.

**30. Në përgjithësi, kërkesat dhe praktikat aktuale për njësitë ekonomike me interes publik nuk janë në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, duke përfshirë ato të kuadrit legjislativ të BE-së në lidhje me depozitimin dhe publikimin e pasqyrave financiare.** Aktualisht, nuk ekzistojnë kërkesa për vënien e dokumentave të Rregjistri Qendror të Shoqërive në dispozicion të palëve të treta të cilat paraqesin një kërkese me shkrim për këtë qëllim, dhe po kështu nuk ekzistojnë sanksione/gjobitje të duhura në rast se nuk vihen në dispozicion dokumenta kontabël apo të tjera siç përshkruhen p.sh në nenin 6 të Direktivës së Parë të BE-së të Ligjit për Shoqëritë Tregëtare. Nuk mund të thuhet se këto kërkesa përfshijnë të gjitha praktikat e mira që vendi duhet të adaptojë, por përmenden si referencë pasi ato kanë ndikim pozitiv mbi disponueshmërinë e pasqyrave financiare, dhe çojnë në krijimin e burimeve të para/fillestare që duhet të shfrytëzohen për ngritjen e infrastrukturës së nevojshme. Shqipëria duhet të vendosë me detyrim sanksione të përshtatëshme për rastet e mosplotësimit të kërkesave për publikim pasi ligjet pa sanksionet e duhura nuk inkurajojnë zbatueshmërinë dhe përputhshmërinë dhe kompromentojnë autoritetin rregullator për zbatimin e tyre në mungesë të parandaluesve të tjerë pozitivë apo negativë.

## B. Profesioni

**31. Profesioni është i ri dhe pavarësisht përpjekjeve të bëra, tre organizmat profesionale ekzistuese hasin vështirësi në përmbushjen e roleve të tyre.** Pas vlerësimit në bazë të Deklaratat e Detyrimeve Anëtarësisë (DDA), të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC), rezulton se Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), Lidhja Profesioniste e Kontabilistëve të Miratuar (LPKM), dhe Shoqata e Kontabilistëve dhe Financierëve të Shqipërisë (SHKFSH) kanë nevojë për një përmirësim të ndjeshëm. Aktualisht organet profesionale po përpiqen t'i japin formë institucioneve të tyre në linjë me IFAC-un dhe DDA –në. IEKA për shembull, ka filluar të fusë pjesën më të madhe të elementeve të përshkruara në DDA dhe IFAC.

*Profesioni i Auditimit*

**32. Titulli "Ekspert Kontabël i Autorizuar" është një titull i mbrojtur dhe individët që e mbajnë atë duhet të jenë anëtarë të rregjistruar të IEKA-s.** Mbrojtja e detyrueshme e të drejtës për të kryer auditimin ligjor mbron interesin publik dhe siguron që vetëm individë të kualifikuar lejohen ta bëjnë këtë. IEKA, anëtare e asociuar e IFAC e krijuar në vitin 1997 dhe organi më i vjetër profesional nga tre ekzistuesit, është quajtuar si organizata profesionale për Ekspertët Kontabël të Autorizuar.

**33. Numri i audituesve në Shqipëri nuk duket se është i mjaftueshëm për të plotësuar kërkesat e tregut.** Aktualisht, ekzsitojnë afro 150 ekspertë kontabël të autorizuar, pjesa më e madhe e të cilëve ushtrojnë profesioni individualisht. Sipas llogaritjeve të Ministrisë së Financës janë afro 2,000 shoqëri të cilat kërkojnë auditime vjetore. Kësaj kërkese për shërbime auditimi i shtohet edhe periudha e "shkurtër" e auditimit pasi shumë shoqëri në Shqipëri duhet të paraqesin pasqyrat e tyre financiare për deklarimet tatimore pranë organeve tatimore jo më vonë se data 31 mars. Në kontekstin aktual, faktorët e kërkesës i shtohen problemit të cilësisë së dobët të auditimit e ndikuar edhe nga mbikëqyrja e kufizuar publike (e diskutuar në paragrafin 34 më poshtë), përmbajtja dhe cilësia e arsimimit dhe provimeve të administruara për kërkesat e kualifikimit profesional (diskutuar në paragrafin 36 më poshtë dhe seksionin II) dhe marrëveshjet për vendosjen e tarifës/çmimit (përshkruar në paragrafin 42 më poshtë).

**34. Profesioni i auditimit vetë-rregullohet pjesërisht nga IEKA dhe mbikqyret nga Ministria e Financave në mbështetje të interesit publik të qeverisë . Megjithatë, rregullimi aktual i profesionit nga qeveria nuk është i mjaftueshëm për përmbushjen e rolit të sistemit të një mbikëqyrjeje publike.** Një sistem i mbikëqyrjes publike të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese është i rëndësishëm me qëllim që të sigurohet që sistemet e kontrollit të cilësisë, investigimit dhe disiplinës janë të mjaftueshëm për inkurajimin e auditimeve me cilësi të lartë. Mbikëqyrja e Ministrisë së Financës mbi IEKA-n ushtrohet nëpërmjet caktimit të një përfaqësuesi kryesor dhe dy përfaqësueve të tjerë (dytësorë) në organin drejtues të IEKA-s, që është Këshilli i saj. Këta përfaqësues miratojnë të gjitha vendimet e marra nga Këshilli me përjashtim të atyre që lidhen me standardet profesionale dhe buxhetin. Ky organizim duhet të përmirësohet, së pari duke bërë të qartë dallimin mes mbikëqyrjes së jashtëme të IEKA-s dhe përfshirjen e drejtëpërdrejtë të kësaj mbëkëqyrje në drejtimin e saj, dhe së dyti, duke ngritur një sistem të mbikëqyrjes publike nëpërmjet ndarje në faza të dispozitave kyçe të Direktivës së Tetë të BE-së të Ligjit për Shoqëritë Tregëtare duke përfshirë por pa u kufizuar në: përzgjedhjen e individëve për të marrë pjesë në procesin e mbikëqyrjes sipas një procedure kandidimi të pavarur dhe transparente; duke siguruar që sistemi drejtohet nga shumica e profesionistëve që nuk ushtrojnë profesion të cilët kanë njohuri në fushat që lidhen me auditimin; dhe nëpërmjet vendosjes së mekanizmave të transparencës duke përfshirë publikimin e programeve të punës vjetore dhe raporteve të aktiviteteve. Ky sistem duhet të ketë përgjegjësinë përfundimtare të mbikëqyrjes publike për:

- Miratimin dhe rregjistrimin të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit ligjor;

- Adaptimin e standardeve mbi etikën, kontrollin e brendshëm të cilësisë së shoqërive të auditimit, dhe
- Kualifikimin e të vazhueshëm, sistemeve të kontrollit të cilësisë, investigimit dhe disiplinës.

**35. Rregullimi i profesionit nga qeveria nëpërmjet Ministrisë së Financës do të duhet të forcohet me qëllim që të shërbejë si kusht për mbikëqyrje publike.** Publiku i interesuar në profesionin e auditimit përbëhet nga klientë, kredidhënës, qeveria, punëdhënës, punonjës, investitorë, komunitetit i biznesit dhe ai financiar dhe të tjerë që kanë besim në objektivitetin dhe intergitetin e audituesve. Çdo sistem efikas i mbikëqyrjes publike duhet të marrë në konsideratë nevojat e të gjitha këtyre palëve të interesuara pasi asnjë nga këto palë, më vete, nuk ka spektrin e duhur dhe të mjaftueshëm për të reflektuar mjaftueshëm interesat e tyre të ndryshme.

**36. Kërkesat minimale për anëtarësim në profesionin e auditimit përcaktohen nga qeveria janë si më poshtë**:

- Kadidatët të jenë të diplomuar nga Fakulteti Ekonomik;
- Mosha e tyre të mos jetë më e vogël se 25 vjeç;
- Të kenë të paktën tre vjet eksperiencë profesionale duke punuar me një auditues dhe/ose shoqëri auditimi të njohur nga IEKA;
- Të kenë marrë me sukses e provimet e organizuara nga Komisioni i Pavarur i Provimeve[8](e diskutuar më gjerë në seksionin II.C më poshtë);
- Kandidatët të kenë nënshtetësi shqiptare që prej të paktën 5 vjetësh, dhe
- Kandidatët të mos kenë kryer asnjë vepër penale.

IEKA kërkon që anëtarët e saj të marrin kualifikim të vazhdueshëm profesional me qëllim që të ruajnë kompetencën profesionale të kërkuar për auditorë të licensuar. Komisioni i Provimeve dhe IEKA besojnë se këto kërkesa të aftësive/kompetencave i kufizojnë anëtarët e profesionit pasi ato mund të përmbushen vetëm nga individë me kualifikim shumë të lartë. Megjithatë, ky opinion nuk ekziston gjërësisht tek të gjithë audituesit, rregullatorët apo shoqëritë në Shqipëri dhe shumë të intervistuar kanë shprehur opinionin se arsimimi dhe kualifikimi, të cilat përshkruhen më gjerë në seksionin II.C, duhet të përshtaten/afrohen më shumë me standardet dhe praktikat ndërkombëtare.

**37. Sistemi për liçensimin e audituesve të huaj në Shqipëri është relativisht i hapur dheme kërkesa minimale.** Ashtu si për shoqëritë audituese lokale**,** liçensimi i shoqërive të huaja kryhet nëpërmjet Komisionit të Rregjistrimit të përbërë nga pesë anëtarë. Komisioni i Regjistrimit është një organizëm i pavarur, dhe IEKA emëron në këtë komision vetëm një nga pesë antarët. Komisioni i Rregjistrimit miraton si auditues individë apo shoqëri vendase dhe të huaja për të ushtruar veprimtaritë e tyre të auditimit.

[8] Anëtarët e Komisionit të Provimit caktohen/emërohen nga Ministri i Arsimit dhe janë: një përfaqësues (kryetari) i caktuar nga Ministri i Arsimit; një përfaqësues nga Ministria e Financës; kryetari i KKK; një përfaqësues nga IEKA dhe një profesor nga Institucionet e Arsimit të Lartë ekspert në fushën e Ligjeve të Kodit Civil apo Kodit Penal.

Individët e huaj të kualifikuar (me një licencë auditimi nga vendi i tyre) duhet të japin një provim mbi ligjet shqiptare që kanë lidhje me auditimin ligjor dhe të dëshmojnë që ata nuk janë pezulluar/përjashtuar nga ushtrimi i profesionit. Shoqëritë e huaja të auditimit duhet të kenë një autorizim për të kryer auditime ligjore në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në vendin e tyre të origjinës dhe të paraqesin provë që nuk u është hequr e drejta për të ushtruar në vendin e tyrë , në mënyrë që të regjistrohen si kontabilistë të miratuar (ata që e ushtrojnë profesionin vetëm) në Shqipëri . Sipas nenit 36 të Vendimit të Qeverisë Nr.150/2000 shoqëritë e huaja të auditimit mund të operojnë në një nga mënyrat e mëposhtme:

- Duke siguruar praninë e audituesve të kualifikuar në Shqipëri për të kryer auditimin;
- Duke ngritur një degë, agjensi apo zyrë në Shqipëri ose
- Duke ngritur apo rregjistruar një shoqëri të varur në Shqipëri e cila është nën zotërimin e plotë nga një ose disa shoqëri të huaja audituese.

Për shkak të numrit ë kufizuar të shoqërive lokale të auditimit në Shqipëri, shoqëritë e huaja audituese kanë zgjeruar grupin e audituesve të disponueshëm me njohuri teorike të dhe aftësi teknike mjaftueshme për të kryer auditimin e pasqyrave fiannciare të përgatitura sipas SNRF-ve. Megjithatë, organizimi aktual paraqet sfida për rregullimin e këtyre shoqërive kur ofrohen shërbime nga jashtë kufijve. Sfida të tilla janë e drejta ligjore për marrjen e dokumentave të punës të mbajtura në vendin ku kryhen shërbimet dhe mundësia për të rishikuar organizimet e kontrollit të cilësisë të shoqërisë në vendin ku kryhen shërbimet. Në këto kushte, do të duhet të krijohet një sistem i përshtatshëm i kontrollit të cilësisë për monitorimin e tyre, ndoshta në bashkëpunim me rregullatorët e vendit ku kryhen shërbimet.[9]

**38. Rregjistri i audituesve i azhornuar dhe i përgatitur çdo vit nga Komisioni i Rregjistrimt duhet të përmirësohet për të siguruar informacion të duhur dhe në kohë.** Rregjistri përmban emra dhe detaje të tjera që lidhen me anëtarët individë, shoqëritë audituese vendase dhe të huaja. Ndonëse është i disponueshëm për publikun, rregjistri nuk është i azhornuar siç duhet në kohë (aktualisht ndodh një herë në vit) dhe nuk përmban të gjithë informacionin e kërkuar për të informuar publikun dhe për të monitoruar me efikasitet aktivitetet e audituesve.

**39. IEKA ka përgatitur Kodin e Etikës për anëtarët e saj në bazë të Kodit të Etikës së IFAC për Kontabilistët Profesionistë.** Kodi i Etikës i IFAC-ut do të shërbejë si referencë për anetarët e IEKAs kur të botohet në fillim të 2007.

**40. Ka të dhëna se pavarësia e audituesve nga njësitë e audituara në praktikë nuk zbatohet/ndiqet gjithmonë.** Praktika aktuale në Shqipëri nuk është në përputhje me kërkesat për pavarësi të Kodit të Etikës së IFAC për Kontabilistët Profesionistë. Mosrespektimi aktual i kërkesave për pavarësi ndikon negativisht mbi vlerën e auditimit edhe pse janë faktorë jashtë profesionit të cilët bëjnë që audituesit të mos veprojnë në mënyrë të pavarur (p.sh kapacitetit i kufizuar i shoqërive për të përgatitur siç duhet pasqyrat financiare).

[9] Kapitujt VIII dhe XI të Direktivës së Tetë të BE mund të japin udhëzime mbi mënyrën se si Shqipëria mund të forcojë rregullat mbi shoqëritë e huaja të auditimit.

**41. Ekziston një nevojë për kërkesa të raportimit të transparencës për audituesit ligjorë të njësive ekonomike me interes publik në Shqipëri.** Për shkak të rëndësisë së *njësive ekonomike me interes pubik* për ekonominë e vendit, nevojiten rregulla më të forta mbi auditimin, duke përfshirë informacion mbi audituesit që kryejnë auditimin e pasqyrave financiare. Raportimi i transparencës nga këto njësi auditimi do të lehtësonte monitorimin dhe mbikëqyrjen e mëtejshme dhe do të forconte besimin e publikut në auditimet ligjore të njësive ekonomike me interes publik. Informacioni që duhet të paraqitet çdo vit nga shoqëria e auditimit duhet të përfshijë: përshkrimin e strukturës ligjore dhe pronësisë; anëtarësinë e rrjetit të shoqërive audituese; përshkrimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë; informacion mbi tarifat e auditimeve ligjore, shërbime të tjera auditimi, konsulencë tatimore dhe shërbime jo-audituese; bazat për pagesën e partnerëve; dhe të tjera.

**42. Çmimet statutore të auditimit për orë për auditorët vendas aktualisht janë të përcaktuara nga Dekreti i Qeverisë Nr. 150/2000. Ricaktohen çdo vit nga Ministria e Financës në konsultim me IEKA-n.** Ky Dekret ka futur një sistem për të përcaktuar kohen normale (numrin e orëve) që nevojitet për të kryer nje auditim bazuar në totalin e aktiveve dhe pasiveve të një shoqëri. Ai gjithashtu përfshin një përjashtim për përdorimin e këtij sistemi në shoqëritë e mëdha, shoqëritë e listuara në bursë, dhe insitucionet financiare. Shoqëritë e huaja të auditimit përjashtohen nga aplikimi i çmimeve statutore të auditimit të vendosura nga Ministri i Financave dhe nga aplikimi i kohës normale (numri i orëve) të përcaktuar me dekretin e qeverisë Nr. 150/2000. Arsyeja për caktimin e çmimit është që të pengohen audituesit të ofrojnë çmime shumë të ulëta në përpjekje për të tërhequr klientë për auditim pa i dhënë shumë rëndësi cilësisë. Ndërkohë që kjo metodë mund të parandalojë "lojën në nivel të ulët" me çmimet e auditimit, një metodë më e mirë do të ishte monitorimi i cilësisë nëpërmjet kontrollit të jashtëm. Kërkesat në Direktivën e Tetë të BE-së mbi pavarësine, duke përfshirë dhe çmimet e auditimit, mund të përdoren si model referimi.

*Profesioni i Kontabilitetit*

**43. Në të kaluarën, Ministria e Financës rregullonte të drejtën për të ofruar shërbime kontabël në Shqipëri ndërkohë që Ligji i Ri për Kontabilitetin (2004) nuk shprehet në lidhje me këtë çështje.** Ministria e Financës i jep titullin Kontabilist i Miratuar individëve të cilët ofrojnë shërbime profesionale të jashtëme kontabiliteti. Për të marrë këtë titull duhet që individi të ketë të paktën tre vjet eksperiencë në kontabilitet dhe të ketë dhënë me sukses një provim të administruar nga Ministria e Financave. Shoqëritë kërkoheshin të përgatisnin pasqyrat e tyre financiare nga një Kontabilist i Miratuar ose nga një punonjës i dipllomuar në Financë, nëse nuk përcaktohej ndryshe në ndonjë rregullore tjetër. Ky mosrregullim i dukshëm i shërbimeve të kontabilitetit është një hap pozitiv për shkak të debatit në BE .[10]

**44. Kontabilistët e Miratur zbatojnë rregulla mbi përgatitjen e Pasqyrave Financiare të specifikuara në ligjin e kontabilitetit dhe në varësi të modelit të raportimit të**

[10] Shih "Impakti Ekonomik i rregullimit në fushën e profesioneve liberale në vende të ndryshme anëtare të BE-së", Ian Paterson, Marcel Fink, Anthony Ogus, Institute for Advanced Studies, Vienë, Janar 2003 (gjendet në DG Competition ëebsite tek http://europa.eu.int/comm/competition).

**zgjedhur, Pasqyrat Financiarejane më të orientuara drejt nevojave të organeve tatimore se sa drejt nevojave te investitorëve.** Ndonëse nuk kërkohet me ligj, praktika aktuale është e tillë ku kërkohet që Kontabilistët e Miratuar të nënshkruajnë pasqyrat financiare dhe deklaratat tatimore së bashku me stafin drejtues dhe audituesit. Kjo praktikë është *de facto* një normë për shkak të opinionit të gjerë sipas të cilit ajo minimizon rrezikun e inspektimeve nga organet tatimore. Fakti që rregullatorët e tatimeve dhe njësitë nuk arrijnë të kuptojnë dallimin mes raportimit për qëllime fiskale dhe raportimit financiar, ka çuar në situatën aktuale e cila përfundimisht sjell paqartësi në pasqyrat financiare.

**45. Afro 1,500 Kontabilistë të Miratuar nuk rregullohen pas fazës së marrjes së titullit.** Afro gjysma e Kontabilistëve të Miratuar në Shqipëri janë anëtarë të Institutit të Kontabilistëve të Miratuar – IKM ( ish LPKM-ja), një pakicë e vogël janë anëtarë të SHKFSH, dhe të tjerët zgjedhin të mos jenë anëtarë të ndonjë organizate profesionale. Kjo situatë sjell shqetësime serioze në lidhje me standardet profesionale dhe ato të etikës që duhet të plotësojnë Kontabilistët e Miratuar dhe ndikimin mbi në cilësine e pasqyrave financiare që ata përgatisin.

**46. IKM bën përpjekje për rregullimin e anëtarëve të saj nëpërmjet rregullave të saj të brendëshme, sic është statuti, rregulloret e brendshme dhe Kodit të Etikës, siç është botuar nga IFAC në 2001, duke përkthyer e adoptuar vetëm *PJESËN A*, e aplikueshme për të gjithë Kontabilistët Profesionistë.** IKM është duke punuar për hartimin e kodeve profesionale dhe per kualifikimin e antarëve të saj me SNRF-te, SKK-të dhe SNA-ve. Megjithatë, zhvillimi i saj pengohet nga fondet dhe kapacitetet e kufizuara. Ajo ka shprehur synimin dhe ka bërë tentativa për negocimin e një marrëdhënie me ACCA në Mbretërinë e Bashkuar (UK). LPKM ka gjithashtu lidhje të ngushta me IEKA-n me të cilën bashkëpunon në fushën e trainimeve mbi SNRF-të. Një bashkëpunim i tillë është kuptimplotë për shkak të burimeve të saj të kufizuara. Më tej, LPKM bashkëpunon gjithashtu me Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Ekonomisë për sa I përket koordinimit të projekteve të kualifikimit.

**47. SHKFSH, një tjetër organizatë kontabilistëve në Shqipëri, përbëhet nga individë të cilët kanë interes për kontabilitetin në vend.** Ajo është një organizatë private me disa kërkesa të tjera për anëtarësim. Në rradhët e saj numërohen Kontabilistë të Miratuar, , profesorë të kontabilitetit, mësues, studentë dhe inspektorë tatimesh dhe doganash.

## C. Arsimimi dhe Kualifikimi Profesional

**48. Arsimimi dhe Kualifikimi Profesional i kontabilistëve dhe audituesve duhet të rishikohet me qëllim që të përmbushë kërkesat e palëve që kërkojnë shërbimet e tyre.** Ekzistojnë sfida të mëdha në lidhje me arsimimin, kualifikimin dhe autorizimin e kontabilistëve dhe audituesve profesionistë në vend. Kështu për shembull, procesi i autorizimit/ miratimit, nuk shihet me shumë konsideratë nga disa punëdhënës dhe punonjës në shoqëritë e auditimit. Arsyet përfshijnë: skepticizmin mbi përmbajtjen e materialeve të trainimit dhe kualifikimit; mungesën e besimit në procesin e provimeve; mungesën e SNRF-ve. Disa punëdhënës preferojnë të sponsorizojnë punonjësit e tyre për trainime dhe kualifikime ndërkombëtare dhe marrjen e diplomave/çertifikatave ndërkombëtare sidomos nga ACCA në UK, dhe disi më pak nga CPA në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

**49**. **Të sapodiplomuarit me rezultate të shkëlqyera nuk janë të tërhequr në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit në Shqipëri.** Në përgjithësi, ata tërhiqen nga ato karriera ku pagat janë të larta dhe prespektiva për një ngritje në karierë janë më të mëdha. Të tilla janë fushat e bankës dhe financës. Për shkak të kompleksitetve në rritje të standardeve dhe rregulloreve, është e nevojshme që individët më të mirë dhe të talentuar të tërhiqen në profesion dhe të mbeten aty.

**50. Programi mësimor i kontabilitetit në universitet sidomos pjesa që lidhet me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditimit si dhe etikën e biznesit, ka disa dobësi.** Këto përfundime u arritën gjatë një studimi të kryer kohët e fundit, *Projekti Pilot për Standardizimin e Arsimimit Global mbi Kontabilitetin i* organizuar nën kujdesin Agjensisë për Zhvillim Ndërkombëtar në Shtetet e Bashkuara (USAID).[11] Programi për kontabilitetin nuk e mbulon mjaftueshëm auditimin apo etikën dhe trajtimi i SNRF-ve është gjithashtu minimal. Përveç rishikimit të programit/kurrikulës është e nevojshme të sigurohen burime efikase për mësimdhënien e tij efektive. Jemi në dijeni të faktit se në kohët e fundit është bërë progres në përmirësimin e ketij programi/kurrikulumi në lidhje me subjektin e Auditimit dhe të SNRF-ve. Mirpo, koha kur na mbërriti ky informacion, nuk na lejoi qe të mund ta vlerësonim më tej. .

**51**. **Përmbajtja e arsimimit për profesionin e kontabilitetit (Kontabilistët e Miratuar) dhe auditimit (Ekspertët Kontabël të Autorizuar) nuk përmbush kërkesat e Standardit Ndërkombëtar të Arsimit (IES) 2, *Përmbajtja e Programeve të Arsimimit Profesional***[12]. Provimi profesional për Kontabilistët e Miratuar nuk trajton ekstensivisht SNRF-të, SNA-të, etikën e biznesit, teknologjinë e informacionit dhe fusha të tjera të rëndësishme. Gjithashtu, provimi profesional për Ekspertët Kontabël të Autorizuar ka nevojë të përmirësohet me qëllim që të trajtojë plotësisht fusha të rëndësishme të tilla si SNRF, SNA, etikën etj. Për më tepër, Kanidadët potencialë duhet të përmbushin të gjitha kërkesat e tjera të aftësive profesionale (të përshkruara në paragrafin 36 më sipër) para se të hyjnë në provimin profesional. Provimet profesionale organizohen dhe mbikëqyren nga Juria e Pavarur e Provimeve, anëtarët e së cilës caktohen nga Minsitri i Arsimit[13]. Pesë fushat e përfshira në provim janë:

- Kontabiliteti, analiza e llogarive dhe “revizion kontabël;”
- Kodi Civil, Ligji për Shoqëritë Tregëtare, Kodi Penal dhe Kodi i Punës deri në masën ku ato prekin pasqyrat financiare ligjore;

[11] Shih *Raportin mbi Rezultatet e Projektit Pilot për Standardizimin e Arsimimit Global mbi Kontabilizimin: Duke Nxitur Integrimin Rajonal, Transparencën dhe Përgjegjshmërinë me anë të Mbështetjes dhe Zhvillimit të Profesionit të Kontabilitetit*, R. William Phelps (USAID) dhe Dr. Gert Karreman (CARANA Corporation). Raporti i plotë mund të lexohet në: http://www.carana.com/assets/gaebFinalReport.pdf

[12] Të gjithë anëtarët e IFAC duhet të përmbushin Standardet Ndërkombëtare të Arsimit (IES) për Kontabilistët Profesionistë, të cilat mund të përshkruhen si “praktika e mirë” përgjithësisht e pranuar në arsimimin dhe zhvillimin e kontabilistëve profesionistë.

[13] Anëtarët e Jurisë së Provimeve përfshijnë një përfaqësues nga Ministria e Arsimit (kryetari), një përfaqësues nga Ministria e Financës, Kryetari i KK, një përfaqësues nga IEKA, dhe një profesor nga Fakultetiti Juridik.

- Rregulloret/normat e kontabilitetit, ato ligjore dhe profesionale (lidhur me profesionin e auditimit, standartet e auditimit, rregulloret profesionale, etiken, etj.);
- Organizimi, menaxhimi dhe kontrollet e brendëshme të njësive ekonomike duke përfshirë sistemet e informacionit dhe kompjuterizimit.
- Tatimet;

Këto pesë fusha nuk mbulojnë mjaftueshëm shkallën e fushave të dhëna në Direktivën e re të Tetë të BE-së apo IES 6, *Vlerësimi i Aftësive dhe Kompetencës Profesionale*. Në mënyrë specifike, fushat e lëna jashtë apo të trajtuara shumë pak përfshijnë SNRF-të, kontabilitetin e kostos dhe menaxhimit, qeverisjen e korporatës, etj.

**52. Periudha aktuale kohore e kërkuar për të plotësuar detyrimin e eksperiencës profesionale si Auditor i Autorizuar është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, cilësia e stazhit duhet të përmirësohet ndjeshëm.** Kërkesa për një eksperiencë pune tre vjeçare duhet të jenë pranë një Eksperti të Kontabël dhe të jenë të mbështetura me një dokument të lëshuar prej tij. IEKA shqyrton dokumentacionin, por nuk kryen një vlerësim të atyre personave që japin kualifikimin/trainimin professional për të siguruar që ata kanë mjedisin e kërkuar të punës apo aftësitë e duhura profesionale. Kjo duhet të rishikohet duke marrë parasysh numrin e vogël të audituesve të aftë për të siguruar një stazh/trainim profesional cilësor.

**53. Provimi aktual për aftësitë profesionale të Kontabilistëve të Miratuar është i pamjaftueshëm për të siguruar që kandidatët e sukseshëm kanë kualifikimet e mjaftueshme.** Provimi profesional i cili organizohet dhe mbikëqyret nga Ministria e Financave, përbëhet nga një pjesë me shkrim ku përfshihen fusha të tilla si Kontabilitetit, Ligji Për Shoqëritë Tregëtare, Ligji Fiskal, Auditimi dhe çështje financiare. Ky provim nuk plotëson kërkesën e IES 6 në lidhje me trajtimin e “sasisë së mjaftueshme të të gjithë spektrit të njohurive profesionale, aftësive profesionale dhe vlerave profesionale, etikës dhe sjelljes me qëllim që vlerësimi të jetë i besueshëm…” Për rrjedhojë, ekzistojnë dyshime mbi aftësitë e individëve të cilët nëpërmjet këtij procesi kanë marrë titullin për të përgatitur pasqyra financiare në përputhje me standarde që sa vijnë e bëhen me komplekse.

**55. Kërkesa e IEKA-s për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional (CPD) për anëtarët e saj është një hap pozitiv dhe në përputhje me tendencat/praktikat ndërkombëtare.** Anëtarët e IEKA-s duhet të kryejnë një program trainimi vjetor të Zhvillimit të Vijueshëm Profesional (CDP) prej minimumi 40 orë me qëllim që të ruajnë kompetencën për kryerjen e auditimeve. Programet CPD duhet të forcohen dhe përmirësohen disi për të siguruar që anëtarët profesionistë zhvillojnë dhe ruajnë mjaftueshëm njohuritë e duhura teorike dhe aftësitë e tyre profesionale. Ky trainim ofrohet aktualisht vetëm nga IEKA, nga anëtarë që janë kualifikuar në mënyrë vjetore nëpërmjet programeve “trainimi i trainuesve”. Në përgjithësi, programet CPD duhet të trajtojnë më në thellësi SNRF-të, SNA-të, çështje të etikës dhe të tjera që lidhen me auditimin.

**55. Ka gjithashtu edhe disa kërkesa të CPD për Kontabilistët e Miratuar të vendosura nga Ministria e Financës ose organet profesionale të kontabilitetit. Sipas një vendimi të Ministrisë së Financave të vitit 1998, Kontabilistëve të Miratuar u kërkohet të**

**përmbushin një minimum prej 2-3 ditë trajnim, çdo dy vjet.** Në lidhje me këtë, LPKM bashkëpunon me IEKA-n për të siguruar kualifikim pas certifikimit të anëtarëve të saj, duke përfshirë disa tema mbi NSRF-të. LPKM ka kryer një kurs të plotë trajnimi për të prezantuar SNRF-të dhe është duke pregatitur kursin e trajnimit mbi Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe një kurs tjetër për SNRF-të.

## D. Vendosja/hartimi i Standardeve të Kontabilitetit dhe Auditimit

**56. Roli i KKK qëndron në dy aspekte: përkthimin e SNRF-ve në shqip dhe përgatitjen e SKK-ve në përputhje me Ligjin e Ri Për Kontabilitetin (2004).** Sipas ligjit të ri, KKK nuk do të jetë më një organ i qeverisë por një "organizatë publike profesioniste me statusin e personit/subjektit ligjor." Si një organ i pavarur, KKK do të ketë përgjegjësinë për financimin e tij dhe aktivitetet e stafit por ekzistojnë shqetësime në lidhje me qëndrueshmërinë e tij për shkak të burimeve të kufizuara. Përveç kësaj, ekzistojnë kritere të forta mbi përbërjen e tij, përzgjedhjen dhe lirimin e anëtarëve.[14] Përkthimi i SNRF- nuk ka filluar akoma edhe pse kanë kaluar gati dy vjet nga miratimi i Ligjit të Ri dhe ndërkohë që financimi i përkthimit është një çështje, gjetja e përkthyesve të aftë për të realizuar një përkthim të një cilësie të lartë përbën gjithashtu një shqetësim më të madh. Edhe pse një situatë e tillë është e ngjashme me atë të vendeve të tjera jo anglisht-folëse, ajo duhet të zgjidhet me qëllim që të fillohet procesi i zbatimit të SNRF-ve. Për më tepër, përkthimi i SNRF-ve do të lehtësonte arsimimin dhe kualifikimin e hartuesve, përdoruesve dhe audituesve të pasqyrave financiare të përgatitura nga *njësitë ekonomike me interes publik*.

**57. Qëndrueshmëria e procesit të hartimit të NAS është e diskutueshme në kushtet aktuale.** KKK ka përdorur me efektivitet bashkëpunime të jashtme për hartimin e NAS për shkak të kapacitetit teknik të kufizuar, nëpërmjet një projekti të financuar nga donatorë. Një kompani konsulente e huaj u kontraktua për të hartuar paketën me katërmbëdhjetë standarde Kombëtare Kontabiliteti "në bazë të SNRF, por të modifikuara dhe përshtatura për mjedisin Shqiptar dhe fazën e zhvillimit të vendit." Për të amenduar këto standarde dhe për të përgatitur standarde të reja duhet të krijohet një proces i qëndrueshëm i hartimit të standardeve. Gjithashtu, burimet e pamjaftueshme të KKK-së mund të ndikojnë mbi statusin e tij si një hartues i pavarur i standardeve të kontabilitetit. Për më tepër, për shkak të qëllimit dhe volumit aktual të punës së KKK-së, organizimi aktual i stafit duhet të përmirësohet ndjeshëm për ta mbështetur atë në aspektet teknike të punës së tij.

**57. Gjatë përgatitjes së SKK-ve pati një proces konsultimi.** KKK ndërmori një proces konsultimi duke ftuar dhe mirëpritur komente dhe duke vënë në dispozicion informacion mbi standardet e reja të kontabilitetit pavarësisht burimeve të kufizuara. Megjithatë, kontabilistët, përdoruesit e pasqyrave financiare, komunitetit i biznesit, autoritetet rregullatore dhe individë e organizata të tjera të interesuara treguan në një masë të gjerë njohuri të pakta ose mungesë njohurish mbi këto standarde kontabiliteti. Ata që kishin njohuri mbi këto standarde të reja, ishin shumë pak të përgatitur për zbatimin e tyre dhe u

[14] KKK duhet të ketë në përbërje dy anëtarë të caktuar nga organizatat profesionale, dy anëtarë të caktuar nga Fakulteti Ekonomik i universiteteve, dy anëtarë të caktuar nga Unioni i Tregëtisë dhe Dhomave të Tregëtisë, dhe tre anëtarë të caktuar nga Ministria e Financës.

shprehën se prisnin që zbatimi i kërkesave të reja të shtyhej për më vonë. Kjo lë të kuptohet se KKK mund të mos merret seriozisht, dhe kjo mund të sjellë ndikime të dukëshme në zbatimin e kërkesave. Ky shqetësim i bashkëngjitet gjithashtu edhe vendimit për shtyrjen e vënies në zbatimi të standardeve deri në 1 Janar 2008. .

**59. Bankat duhet të përgatisin pasqyrat e tyre financiare në përputhje me Manualin e Kontabilitetit Për Bankat i cili ka nevojë për përditësim.** Ai u përgatit nga Banka e Shqipërisë dhe u miratua nga Këshilli i Ministrave në vitin 1998 dhe përbëhet nga katër pjesë kryesore:

- Plani i llogarive dhe parime të përgjithshme të kontabilitetit dhe parime të përgjithshme të mbajtjes së llogarive dhe dokumentacionit të kontabilitetit;
- Skemat kontabël–përshkrim të parimeve që lidhen me veprimet kryesore bankare dhe një numër shembujsh të veprimeve më të zakonëshme bankare me rregjistrimet korresponduese kontabël;
- Formati i pasqyrave financiare; dhe
- Format e raportimeve që duhet të paraqiten në Bankën e Shqipërisë për qëllime mbikëqyrje.

Manuali i Kontabilitetit për Bankat tregon se pasqyrat financiare të bankës përbëhen nga bilanci, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e zërave jashtë bilancit, pasqyra e fluksit të parasë, dhe shënimet shpjeguese.

**60. Aktualisht nuk është i qartë autoriteti i hartimit të standardeve për bankat.** Ligji për Kontabilitetin (2004) kërkon që bankat të përgatisin pasqyrat e tyre financiare në përputhje me SNRF-të ndërsa Ligji për Bankat kërkon që bankat të përgatisin pasqyrat financiare ligjore sipas Manualit të Kontabilitetit për Bankat të përgatitur nga Banka e Shqipërisë. Ligji duhet të qartësojë se cilat standarde janë të zbatueshme dhe përfundimisht të përcaktojë hartuesin e standardeve për bankat, meqënëse ka të ngjarë të ketë kontradikta mes SNRF-ve dhe Manualit të Kontabilitetit për Bankat. Në të kundërt, bankat mund të ndihen të detyruara të përgatisin dy grupe pasqyrash financiare.

*Standardet e Auditimit*

**61. Mungon një autoritet i caktuar ligjor për të vendosur standardet kombëtare të auditimit.** Në kushtet e kësaj mungese, IEKA si një organ përgjegjës për zhvillimin e standarteve profesionale (siç përmëndet në vendimin e qeverisë No. 150/2000) për anetarët e saj, ka vendosur që të përdorë versionin e përkthyer të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të vitit 1999 për anëtarët e saj për periudhat kontabël që mbyllen më 31 dhjetor 2003 ose pas kësaj date. Veprimi i IEKA-s e bën atë *de facto* një organ të vendosjes së standardeve të auditimit në Shqipëri. Me qëllim që të mbushet ky boshllëk në kuadrin ligjor, është përgatitur një Projekt Ligj i ri për Auditimin i cili bën të detyrueshëm përdorimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të përkthyera në gjuhën shqipe.

**62. Roli i Këshillit të IEKA- si një organ *de facto* i vendosjes së standardeve të auditimit është përkthimi i SNA-ve.** Anëtarë të IEKA-s, të caktuar nga Këshilli i IEKA-s në Komitetin Drejtues për Standardet, dtrejtuan përkthimin e versionit të manualit të IFAC të vitit 1999 për Standardet e Auditimit, Kontrollit dhe Etikës, të cilat trajtonin SNA-të dhe

IPSA-të. Pas një rishikimi dhe redaktimi ata u miratuan me shumicë votash nga Këshilli i IEKA-s. Ndryshimet ose modifikimet e SNA-ve që prej vitit 1999 publikohen në Ditarin e IEKAs. Aktualisht, IEKA ka firmosur një marrëveshje me IFAC-un, që përputhet me politikat e përkthimit të IFAC, për përkthimin/riprodhimin/shpërndarjen e manualit për Auditim Ndërkombëtar, Siguri dhe Prononcime Etike. Pas një periudhe shqyrtimi dhe editimi do të publikohen në 2007, dhe do të bëhen të detyrueshme për antarët në Janar 2007

### E. Vënia në zbatim e standardeve të kontabilitetit dhe auditimit

**63. Mekanizmat ekzistuese të monitorimit dhe detyrimit për zbatim në lidhje me raportimin financiar të njësive ekonomike të parregulluara nuk janë efikase.** Ligji i mëparshëm për Kontabilitetin përcaktonte se Ministria e Financës mund të vendosë gjoba që shkojnë nga 3000 deri në 5000 lekë (afro 24-40 Euro) për çdo anëtar të bordit të drejtuesve, ose palë të treta që përgatisin pasqyra financiare në raste të moszbatimit të standardeve të kontabilitetit por nuk ka ndonjë rast të raportuar të aplikimit të këtyre gjobave. Ka dyshime nëse gjobave të tilla me vlera të ulëta mund të shërbejnë për të parandaluar mospërputhshmërinë me standardet. Ligji i ri për kontabilitetin nuk përcakton sanksione për rastet e mospërputhshmërisë më kërkesat e ligjit. Kjo çështje duhet të zgjidhet pasi situata aktuale mban në vetvete edhe mungesën e një boshti efikas auditimi për të raportuar mbi mos- zbatimin e kërkesavë të kontabilietit dhe raportimit financiar.

**64. Prioriteti i Bankës së Shqipërisë në nxitjen e zbatimit lidhet me raportimin e për qëllime të kujdesit dhe jo me raportimin financiar për qëllime të përgjithshme.** Pasqyrat financiare ligjore të bankave të përgatitura sipas ligjit të mëparëshëm të kontabilitetit janë në përgjithësi të një cilësie të mirë për shkak të rregullave të detajuara të kontabilitetit që udhëheqin sektorin bankar dhe funksionet e zbatimit që kryhen nga Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë. Megjithatë, kalimi tek standardet e reja të kontabilitetit (përshkruar në paragrafin 17 dhe 60 më sipër) mund të çojë në një rënie të cilësisë së pasqyrave financiare deri sa mbikëqyrësit dhe hartuesit e tyre të familiarizohen me standardet e reja. Ligji për Bankat përcakton autoritetin e Bankës së Shqipërisë për të nxitur zbatimin e rregullave të kontabilitetit dhe kryerjen e aktiviteteve të mbikëqyrjejes. Mbikëqyrësit kryejnë ekzaminime të plota në çdo bankë një herë në vit. Ndonëse kjo siguron një kontroll të rregullt të zbatimit të rregullave të kontabilitteit, Banka e Shqipërisë fokusohet me shumë në raportimin për qëllime kujdesi se sa në raportimin financiar për qëllime të përgjithshme. Rrjedhimisht, deklarimet jo të sakta dhe gabimet në pasqyrat financiare për qëlime të përgjithshme mund të mbeten të pazbuluara për publikun nëse opinione të kujdesit nuk i garantojnë ato.

**65. Stafi në Bankën e Shqipërisë që merret me aktivitetet e zbatimit duket i mjaftueshëm por ai duhet të trainohet për të vënë në zbatim me efikasitet nenin 4 të Ligjit të Ri për Kontabilitetin (2004).** Aktualisht numërohen 22 persona në Departamentin e Mbikëqyrjes, 18 të përfshirë në mbikëqyrjen në banka dhe 4 jo në banka. Ky staf duket i mjaftueshëm për shkak të numrit të bankave dhe për faktin se mbikëqyrësit e bankave kanë ekspertizë në kërkesat e kontabilitetit të përcaktuara në Manualin e Kontabilitetit për Bankat dhe mund t'i sfidojnë bankat e tjera dhe audituesit kur ka raste diferencash/dallimesh. Pas vënies në zbatim të SNRF-ve, mbikëqyrësve të bankës do tiu duhet të kenë njohuri teknike të mjaftueshme kontabiliteti, për shembull mbi SNRF 7,

*Instrumentet Financiarë: Shënimet shpjeguese*, SNK 32, *Instrumentet Financiarë*, Shpjegimet dhe Paraqitja, dhe SNK 39, *Instrumentet Financiarë: Njohja dhe Matja* me qëllim që të monitorojnë dhe nxisin zbatimin e SNRF-ve.

**66. Është e paqartë se çfarë sanksionesh mund të vendosen në rast se një bankë e caktuar nuk ka respektuar kërkesat e kontabilitetit dhe raportimit financiar.** Ligji për Bankat përcakton sanksione për mosrespektimin e dispozitave të ligjit. Gjobat përfshijnë: sanksione administrative dhe zhdëmtime, gjoba për Bordin e Drejtorëve dhe bllokim liçense. Megjithatë nuk përmendet ndonjë sanksion specifik në lidhje me mosrespektimin e kërkesave të kontabilitetit dhe raportimit financiar dhe nëse stafi menaxhues, njësia ose të dyja do të mbajnë përgjegjësi për këtë. Ligji Për Kontabilittein (2004) i referohet vetëm detyrimeve të përgjithshme administrative, detyrimit civil apo penal në bazë të dospozitave të Kodit Civil, Kodit Penal apo ligjeve të tjera në bazë të dëmeve të shkaktuara apo kërkesës së palëve të interesuara. Nuk ka ndonjë të dhënë që tregon mbi palët që duhet të ndëshkohen në raste shkeljesh. Qartësia e kërkesave dhe sanksioneve në rast të shkeljeve është një mbështetës i rëndësishëm i një kuadri zbatimi pasi ai iu bën të qartë palëve të interesuara (pjesëmarrësve) detyrimet dhe gjobat në çdo rast.

**67. AMS ende nuk është një nxitës efikas i zbatimit i kërkesave të kontabilitetit dhe raportimit financiar nga shoqëritë e sigurimeve në Shqipëri.** Departamenti i mbikëqyrjes në AMS ka shtatë anëtarë nga të cilët tre merren me mbikëqyrjen jo në terren. Fokusi kryesor është mbi raportimin për qëllime kujdesi sesa mbi raportimin financiar për qëllime të përgjithshme. Stafi me eksperiencë dhe formim kryesisht në fushën e financës, i kushton më tepër vëmendje të dhënave teknike dhe atyre të performancës dhe ka ekspertizë të kufizuar analizimin e trajtimeve kontabël të pasakta në pasqyrat financiare të paraqitura në AMS. Mangësitë e konsiderueshme në pasqyrat financiare të shqyrtuara dhe diskutuara në Seksionin III, dhe mungesa e sanksioneve të zbatuara mbi ndonjë shoqëri të përfshirë tregon mungesën e nxitjes së zbatimit të standardeve të kontabilitetit në sektorin e sigurimeve. Efikasiteti i AMS-së varet nga rritja e numrit dhe ekspertizës së stafit te mbikëqyrjes dhe nga respektimi i autoritetit të saj nga ato njësi që janë subjekt i kontrollit të saj.

*Standardet e Auditimit*

**68. Sistemi i IEKA-s për kontrollin e cilësisë ka nevojë për përmirësim të ndjeshëm me qëllim që të zbulohet vazhdimisht dhe në kohë mospërputhshmëria me standardet e auditimit.** Autoriteti i IEKA-s për të kryer dhe monitoruar respektimin e standardeve të auditimit është përcaktuar me Vendimin 15/2002 të Këshillit të IEKA-s sipas të cilit IEKA duhet të kryejë kontrolle të detyrueshme të anëtarëve të saj, duke përfshire ata që e ushtrojnë profesionin vetëm, çdo katër vjet ose dhe më shpesh nëse dyshohet për mospërputhshmëri. Për shkak të mungesës së stafit me experience të mjaftueshme, kontrollet kryhen një herë në shtatë vjet. Monitorimi dhe detyrimi për zbatim kryhen nga një nën-komitet i Këshilllit të IEKA-s – Komitetit i Kontrolllit të Cilësisë. Çdo vit ky komitet përzgjedh dhe miraton anëtarët e IEKA-s të cilët do të kryejnë kontrolle të cilësisë. Ai harton programin e punës dhe udhëzimet për këto kontrolle dhe kryen trainime për ata që do të merren me kontrollin. Nëpërmjet këtij sistemi janë kryer 28 kontrolle duke

përfaqësuar afro 20 % të anëtarëve, në vitin 2005. Nuk është kontrolluar asnjë auditues lokal anëtar i një shoqërie auditimi të rrjeteve ndërkombëtare dhe shkak për këtë ka qënë gjuha pasi këto shoqëri i kanë pjesën më të madhe të dosjeve të tyre të auditimit në gjuhën angleze (referohuni paragrafit 37 më sipër). Procesi i kontrollit të cilësisë duket joefikas për shkak të niveleve të njohurive dhe eksperiencës së kontrolluesve.

**69. Përputhshmëria e plotë e IEKA-s me SMO 1 *Kontrolli i Cilësisë* dhe me Direktivën e Tetë të BE-s do të forconte monitorimin e përputhshmërisë me standardet e auditimit.** Me qëllim që të përmirësohet sistemi aktual dhe të adaptohen praktikat më të mira ndërkombëtare, si për shembull ato që jepen në Direktivën e Tetë të BE-së, IEKA duhet të rishikojë aspekte të tilla si arsimimin profesional dhe kriteret për ata që kryejnë kontrolle; procesin e përzgjedhjes së kontrolluesve; financimin e procesit të kontrollit dhe mënyrën si ai ndikon në pavarësinë e procesit dhe atë të kontrolluesve; qëllimin e kontrollove; dhe publikimin vjetor të rezultateve të përgjithshme të kontrolleve. Përveç këtyre, duhet të plotësohen edhe kërkesat e SMO 1 *Kontrolli i Cilësisë,* në lidhje me standardet e kontrollit për anëtarët e tij, si për shembull aplikimi i një metodë kontrolli me bazë rrezikun dhe ndërmarrja e veprimeve korrigjuese dhe displinare.

**70. Investigimi dhe disiplina për mospërputhshmërinë me standardet e auditimit dhe rregullat e etikës dhe pavarësisë kryhet nga Komisioni i Disiplinës me input nga IEKA[15].** Komisioni, i cili është i pavarur nga IEKA ka përgjegjësinë për investigimin e ankesave të bëra kundër audituesve të rrregjistruar nga IEKA apo nga palë të treta. Apelimet ndaj vendimeve trajtohen nga Dhoma e Apelit për Çështjet Dispilinare, anëtarët e të cilës janë të ndryshëm nga ato të Komisionit të Disiplinës. Nga katër apo pesë raste të referuara çdo vit nga IEKA në Komisionin e Disiplinës (diskutuar në paragrafin 70 më poshtë) nuk është e qartë se sa prej tyre kanë ardhur si rezultat i rasteve të përsëritura të mosplotësimit të standardeve të auditimit. Sanksionet që përdor IEKA përpara se cështja të shkojë tek Komisioni i Disiplinës përfshijnë shkresat paralajmëruese. Sanksionet nuk përfshijnë autoritetin për të gjobitur, pezulluar apo lirimin e antarëve nga IEKA, meqë këto sanksione mund të imponohen vetëm nga Komisioni i Disiplinës Katër ose pesë raste raportohen para Komisionit të Disiplinës çdo vit. Megjithatë, meqenëse Komisioni i Disiplinës nuk publikon një raport mbi aktivitetet e tij, natyra e rasteve të raportuara dhe përfundimet e tyre nuk janë të disponueshme. Nuk ekziston një dallim i qartë mes procesit të investigimit dhe atij të disiplinës me qëllim që të mbrohen të drejtat e anëtarëve dhe personave të tjerë të përfshirë në proces. Kjo mund të zgjidhet duke iu referuar SMO 6 *Investigimi dhe Disiplina*.

[15] Komisioni për Disiplinën ka një avokat (kryetari) i caktuar nga Ministri për Bashkëpunim Ekonomik dhe Tregëti, një anëtar i caktuar nga Ministri i Drejtësisë, një anëtar i caktuar nga Ministri i Financës; një profesionist i kualifikuar në fushën e menaxhimit të njësive ekonomike i caktuar nga Dhoma e Tregëtisë dhe një anëtar nga IEKA.

## III. STANDARDET E KONTABILITETIT TË HARTUARA DHE TË VËNA NË PRAKTIKE

**71. Ky seksion jep një përmbledhje të analizës së problemeve me standardeve të kontabilitetit dhe problemeve me përputhshmërinë e tyre.** Analiza e *problemeve* me standardet bën një krahasim të kërkesave të Planit të Përgjithshëm të Kontabilitetit në Shqipëri (këtej e tutje do ti refereohemi si PKK) me SNRF-të për të përcaktuar dallimet e rëndësishme të cilat mund të ndikojnë negativisht mbi besueshmërinë e pasqyrave financiare të hartuara sipas PKK (referohu paragrafeve 72 dhe 74 më poshtë). Analiza e *problemeve me përputhshmërinë* përqëndrohet në përputhshmërinë e pasqyrave financiare ligjore dhe vullnetare/kontraktuale (të kërkuara nga një huadhënës) me PKK-në dhe SNRF-të, përkatësisht me qëllim që të identifikohen mangësitë e mundëshme (shih paragrafin 75 dhe 80 më poshtë).

**72. Rishikimi i Planit të Përgjithshëm të Kontabilitetit dhe informacioni i dhënë nga palët e përfshira nxori në pah një sërë askpektesh ku kishte dallime mes PKK-së dhe SNRF-ve.** Kjo analizë u krye në bazë të kërkesave në fuqi në kohën e rishikimit, të përcaktuara në Ligjin për Kontabilitetin (1993) dhe Planin e Përgjithshëm të Kontabilitetit.[16] Disa dallime kryesore të përzgjedhura mes PKK-së dhe SNRF-ve të cilat mund të kenë një ndikim të ndjeshëm në pasqyrat financiare *të njësive ekonomike me interes publik* janë*:*

- ***Një sërë aspektesh që lidhen me shoqëritë e parregulluara nuk gjenden të trajtuara në asnjë standard.*** Këtu përfshihen SNRF 3, *Kombinimet e Bizneseve*; SNRF 5, *Aktivet Afatgjata të Mbajtura për Shitje dhe Veprimtaritë e Ndërprera;* SNK 11, *Kontratat e Ndërtimit*; SNK 14, *Raportimi i Segmenteve;* SNK 17, *Lizingu*; SNK 19, *Përfitimet e Punonjësve*; SNK 23, *Kostot e Huamarrjes*; SNK, 28, *Investimet në Pjesëmarrje*; SNK 30, *Shënimet Shpjeguese në Pasqyrat Financiare të Bankave dhe Institucioneve të ngjashme Financiare*; SNK 31, *Interesi në Sipërmarrjet e Përbashkëta (Joint Ventures)*; SNK 34, *Raportimi Financiar i Ndërmjetëm*; SNK 36, *Rënia në Vlerë e Aktiveve*; dhe SNK 40, *Pronat për Investim.*
- ***Politikat e kontabilitetit, shënimet shpjeguese dhe të tjera janë të kufizuara.*** Kërkesat aktuale ndryshojnë nga SNK 1, *Paraqitja e Pasqyrave Financiare,* pasi Pasqyra e Fluksit të Parasë dhe Pasqyra e Ndryshimeve të Kapitalit nuk kërkohen. Kërkesa të tjera si ato të specifikuara në SNK 10, *Ngjarjet pas Bilancit*, SNK 20, *Kontabiliteti për Grantet Qeveritare dhe Shënimet Shpjeguese të Ndihmës Qeveritare*, SNK 24 *Shënimet Shpjeguese mbi Palët e Lidhura,* dhe SNK 37, *Provizionet, Detyrimet dhe Aktivet e Mundëshme* nuk kërkohen.
- ***Trajtimet e ndryshme të zërave kyçe*** të cilat mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare dhe përfshijnë***:***
  - SNK 16, *Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara (AQT)* lejon një shumllojshmëri të metodave të amortizimit me qëllim që shuma/vlera e

[16] Misioni për due diligence u krye në muajin dhjetor 2005 para shfuqizimit të Ligjit të Ri për Kontabilitetin (1983). Në muajin dhjetor 2005 u vendos kërkesa që njësitë ekonomike të përgatisnin pasqyrat financiare në përputhje me Ligjin e Kontabilitetit (1993) dhe Planin e Përgjithshëm Kontabël.

amortizueshme e një aktivi të shpërndahet në bazë sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. PKK lejon vetëm përdorimin e metodës në vijë të drejtë në bazë të të cilës nuk mund të reflektohet mjaftueshëm modeli i përdorimit të AQT-ve dhe mund të çojë në një nën apo mbivlerësim të aktiveve dhe të ardhurave.

- o SNK 21, *Efektet e Ndryshimeve në Këmbime Valutore* kërkon që humbjet dhe fitime nga këmbimet valutore të njihen në pasqyrën e të adhurave dhe shpenzimeve ndërsa sipas PKK-së, fitimet dhe humbjet nga këmbimet valutore paraqiten të shtyra në bilanc deri në momentin kur bëhet çrregjistrimi i aktivit monetar me të cilin ato lidhen. Kjo mund të sjellë një nën apo mbivlerësim të aktiveve apo detyrimeve totale në bilanc.

**73. Momentalisht ka dallime specifike mes SNRF-ve dhe Manualit të Kontabilitetit për Bankat (MKB) për sa u takon bankave.** Siç është përmendur në paragrafin 18 më sipër, bankat duhet të përgatisin pasqyrat e tyre financiare sipas Manualit të Kontabilitetit për Bankat. Disa dallime të rëndësishme që mund të kenë një impakt të rëndësishëm në pasqyrat fianciare të bankave përfshijnë sa më poshtë:

- ***Manuali për Bankat nuk reflekton ndryshimet në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (tashmë, SNRF) që prej vitit 1998***. Të patrajtuara janë SNK 30, *Shënimet Shpjeguese në Pasqyrat Financiare,* SNK 32, *Instrumentat Financiarë: Shpjegimi dhe Paraqitja*, SNK 39, *Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja*. Rrjedhimisht, Manuali i Kontabilitetit për Bankat ka dallime të rëndësishme nga “SNRF-të e plota,” sidomos për sa i përket njohjes, matjes dhe shpjegimit të instrumentave financiarë dhe natyrës e shkallës së rreziqeve që vijnë nga këta instrumenta. Kjo mund të pengojë përdoruesit e pasqyrave financiare të bankave në marrjen e një paraqitje të drejtë dhe të vërtetë të gjendjes financiare të bankave.
- ***Shumat e parashikuara për hua bazohen në një metodologji formule e cila mund të sjellë një nën apo mbi vlerësim të portofolit të huasë në krahasim me SNRF-të.*** Sipas Manualit të Kontabilitetit për Bankat, bankat duhet të llogarisin zhvlerësimin në pjesën e pasiguruar të huave dhe llogarive të arkëtueshme në bazë të një matrice provizionimi që specifikon një shkallë të përcaktuar shifrash minimale për çdo kategori huash (Standarde – 1%, Nën vëzhgim – 5%, Nënstandarde – 20%; Të dyshimta – 50%; dhe Me humbje – 100%). Ndonëse kjo metodë mund të quhet e mjaftueshme për qëllime kujdesi, ajo nuk është në përputhje me SNK 39, sipas të cilit kërkohet që shuma e parashikuar për humbjet nga huatë të llogaritet si diferencë mes vlerës kontabël të aktivit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhëshme te parashikuara të parasë (duke përjashtuar humbjet e ardhëshme në kredi të cilat nuk kanë ndodhur ende) e zbritur me normën fillestare efektive të interesit të mjetit financiar. Përdorimi i shifrave minimale të provizionimit ka pasojat e mëposhtëme:
  - o Nuk lë shumë vend për gjykim mbi vlerësimin e huave, gjë që thjeshton ndjeshëm zbatimin e kërkesave të kontabilitetit dhe paraqet një shkallë të caktuar “kujdesi” në llogaritë e bankës.
  - o Mund të mesatarizohen rezultatet mbi sektorin bankar të raportuara nga banka të ndryshme gjatë gjithë kohës, gjë që mund të ndikojë negativisht në kapacitetin e Bankës së Shqipërisë për zbulimin e ndryshimeve në rreziqet e sektorit bankar dhe rreziqet që ka një bankë e caktuar. Ajo mund të pengojë gjithashtu edhe disiplinën e tregut.

- o Mund të prekë vlerat e normës së interesit përderisa bankat duhet të lënë mënjanë një provizion minimal pavarësisht rrezikut aktual të kredisë të një hamarrësi.

Ndonëse këto kërkesa duhet të lidhen vetëm me raportimim për qëllime kujdesi dhe jo me raportimin financiar sipas SNRF-ve, nga studimi u vu re se disa banka përdorin gjithashtu edhe rregulloren e Bankës së Shqipërisë në përgatitjen e pasqyrave të tyre financiare (vullnetare) sipas SNRF-ve. Po kështu, u vu re se autoritetet e mbikëqyrjes dhe shoqëritë e auditimit nuk e përballojnë gjithmonë faktin se kërkesat për një kontabilitet të kujdesshëm përzihen në pasqyrat financiare sipas SNRF-ve.

- ***Pezullimi i interesit të llogaritur mbi aktivet e rëna në vlerë nuk është në përputhje me metodologjinë e fluksit të skontuar të parasë në SNK 39.*** Sipas rregulloreve, kërkohet që bankat të pezullojnë llogaritjen e interesit per të gjitha huatë e klasifikuara si "nënstandarde" apo të këqija. Ndonëse ky pezullim i llogaritjes se interesit është i arsyeshëm në kontekstin e një metodologjie me bazë formule për llogaritjen e humbjes nga huaja, ai nuk është në përputhje me SNK 39, pasi bie ndesh me politikën e matjes së fluksit të skontuar të parasë (referohuni SNK 39, Udhëzime mbi Zbatimin (AG), Seksioni 93).
- ***Kapitali aksioner luhatet me ndryshimet në kurset e këmbimit valutor.*** Manuali i Kontabilitetit për Bankat kërkon që bankat të rivlerësojnë kapitalin e tyre aksioner duke përdorur kursin e këmbimit në datën e mbylljes së bilancit për çdo bilanc, gjë që çon në një diferencë nga kurset e këmbimeve e rregjistruar si "diferenca nga rivlerësimet." Kjo diferencë nga rivlerësimi, përfshihet gjithashtu edhe në përcaktimin e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit. Një trajtim i tillë kontabël ndryshon nga trajtimi sipas SNRF-ve ku kërkohet që kapitali të konsiderohet si një "mjet jo-monetar" dhe rrjedhimisht të matet me kosto historike në një monedhë të huaj dhe të konvertohet duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit, në mënyrë që të mos rregjistrohet asnjë diferencë nga rivlerësimi.
- ***Komisionet bankare njihen që në momentin e përftimit dhe nuk kalojnë në pasqyrën e te ardhurave dhe te shpenzimenve duke përdorur interesin efektiv.*** Sipas Manualit të Kontabiliteit për Bankat, kërkohet që komisionet për dhënie apo marrje huaje të njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin kur ato ndodhin përkatësisht. Kjo metodologji nuk është në përputhje me matjen e intrumentave financiarë me koston e amortizuar sipas SNK 39, ku kërkohet që komisionet të shtyhen dhe amortizohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë të normës efektive të interesit të instrumentit.
- ***Kontratat forward të këmbimeve valutore nuk rregjistrohen në pasqyrat financiare.*** Manuali i Kontabilitetit pë Bankat kërkon që kontratat forward të këmbimeve valutore të trajtohen si transaksione jashtë bilancit, pra, nuk rregjistrohen as në bilanc e as në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve deri sa ato të shlyhen me anë të pagesës apo arkëtimit të monedhave që do të këmbehen. Fitimet apo humbjet nga kontratat forward të këmbimeve valutore kontabilizohen në datën e shlyerjes/pagesës. Kjo metodologji nuk është në përputhje me SNK 39, në të cilin kërkohet që të gjitha instrumentat derrivativë duke përfshirë edhe kontratat forward të këmbimeve valutore të maten me vlerën e drejtë (të tregut), ku ndryshimet në këtë vlerë rregjistrohen në pasqyrën e të

ardhurave dhe shpenzimeve ose në kapital në rast të instrumentave të mbrojtjes së fluksit të parasë. Plotësimi i kërkesave të SNK 39 do të ndihmonte për një transparencë më të madhe dhe një menaxhim më të mirë të instrumentëve të tillë financiarë.

74. **Për sa i takon shoqërive të sigurimeve, vihen re dallime specifike mes kërkesave të SNRF-ve dhe kërkesave të kontabilitetit në Shqipëri.** Shoqëritë e sigurimeve duhet të përgatisin pasqyrat financiare në përputhje me Ligjin Për Kontabilitetin dhe Rregulloren Nr. 1 "Mbi Raportet Vjetore të Shoqërive të Sigurimeve dhe Risigurimeve" të nxjerra nga AMS. Diferencat mes PKK-së dhe SNRF-ve vijnë si rezultat i kombinimit të dy faktorëve d.m.th. (i) shoqëritë e sigurimeve janë subjekt i të njëjtave kërkesa për raportim si njësitë e tjera ekonomike, gjë që nuk përputhet me SNRF-të e plota; dhe (ii) shoqëritë e sigurimeve duhet gjithashtu të zbatojnë rregulloret e nxjerra nga AMS në lidhje me matjen/vlerësimin e rezervave teknike, të cilat bëhen mbi bazë formule dhe ndryshojnë ndjeshëm nga parimet e matjes që zbatohen sipas "SNRF-ve të plota." Kështu, shoqëritë e sigurimeve llogarisin rezervat për dëme të ndodhura por të paraportuara, sipas një metode mbi të cilën bien dakord me AMS. Ndonëse kjo mund të mjaftojë për tregun në fazën aktuale të zhvillimit, industria do të duhet të zhvillojë ekspertizën që të mundësojë një matje specifike dhe të saktë të rezervave e cila duhet të jenë e qëndrueshme në kohë dhe në të gjithë industrinë.

**75. Në vlerësimin e problemeve me përputhshmërinë, ROSC mori në shqyrtim:**

- **Tetë grupe pasqyrash financiare të audituara,** të dy njësive ekonomike, një shoqërie sigurimesh, dhe pesë bankave, **me pretendimin se ato janë përgatitur në përputhje me SNRF-të.** [17] Numri i vogël i njësive ekonomike dhe shoqërive të sigurimeve është kryesisht për shkak të vështirësive në mbledhjen e pasqyrave financiare të përgatitura në përputhje me SNRF-të.[18]

- **19 grupe të pasqyrave financiare të audituara,** të 11 njësive ekonomike, katër bankave, dhe katër shoqëri sigurimesh, **të cilat pretendohen të jenë përgatitur sipas PKK-së.** [19] .

**76. Pasqyrat financiare të konsoliduara të përgatitura sipas SNRF-ve shpesh përfshijnë një pjesë të konsiderueshme të formulimeve standarde me fjalë, të cilat mund të mos perputhen mjaftueshëm me ngjarjet dhe rrethanat e shoqërisë dhe reduktojnë rëndësinë (kuptimore) të pasqyrave financiare për përdoruesit e jashtëm.** Formulimi standard, zakonisht merret nga modelet e pasqyrave financiare të

---

[17] Të gjitha pasqyrat financiare të vëzhguara janë audituar nga shoqëri audituese lokale anëtare të rrjeteve të shoqërive audituese ndërkombëtare. Katër raporte auditimi ishin me opinion auditimi pa rezerva (njëra përmbante një paragraf ku theksohej çështja), tre kishin opininon auditimi me rezerva, dhe njëra kishte opinion të pashprehur të audituesit.

[18] Pasqyrat Financiare sipas SNRF-ve nuk kërkohen me ligj kështu që nuk vihen në dispozicion. Për shkak të numrit të vogël të përzgjedhur, ato nuk mund të konsiderohen se përfaqësojnë të gjithë shoqëritë. Kështu që, konkluzionet ndonëse të dobishme për ilustrimin e problemeve potenciale në raportimin financiar kanë të bëjnë me mungesat e gjetura në pasqyrat financiare të shoqërive të veçanta.

[19] Shtatë grupe pasqyrash financiare në modelin e përzgjedhur për vëzhgim janë të audituara nga shoqëri auditues lokale anëtare të rrjeteve të shoqërive audituese ndërkombëtare dhe 12 grupe nga shoqëri audituese lokale apo auditues individualë. 13 raporte auditimi ishin përmbanin opinion auditimi pa rezerva, pesë me opinion auditimi me rezerva dhe një raport ishte i paqartë.

ofruara nga shoqëritë lokale të auditimit anëtare të rrjeteve të shoqërive audituese ndërkombëtare dhe pasqyrojnë mungesën e njohurive dhe të kuptuarit të SNRF-ve. Në shumë raste, formulimi standard përdoret në politikat e kontabilitetit për ngjarjet dhe transaksionet të cilat nuk janë të rëndësishme për shoqëritë në fjalë. Shoqëritë audituese pohojnë se ata nuk 'përgatisin' pasqyra financiare[20] por vetëm asistojnë në përgatitjen e tyre për aq sa u lejon etika.

**77. Pasqyrat financiare të konsoliduara të dy njësive ekonomike të përgatitura sipas SNRF-ve rezulatojnë se janë vërtet në përputhje me SNRF.** Përveç aspektve të mospërputhjeve të vëna në dukje nga audituesit në raporet e tyre, nuk u identifikua ndonjë aspekt tjetër i rëndësishëm i mundshëm mospërputhshmërie. Siç është përmendur më sipër, grupi i pasqyrave financiare të njësive ekonomike të përgatitura sipas SNRF-ve është i vogël, kështu që përfundimet e vlerësimit të mësipërm nuk mund të përfaqësojnë kapacitetet e sektorit të njësive ekonomike në Shqipëri për të siguruar përputhshmëri me SNRF-të. Megjithatë, nga analiza e këtyre pasqyrave financiare, takimet me disa njësi ekonomike dhe audituesit e tyre, mund të jepen disa konkluzione si më poshtë:

- ***Ka mungesë kontabilistësh me eksperiencë në SNRF:*** Dy shoqëritë që u morën në vëzhgim janë shoqëri të krijuara kohët e fundit me investim të huaj të drejtëpërdrejtë dhe paraqitën vështirësi në punësimin dhe mbajtjen e kontabilistëve të kualifikuar të aftë për të përgatitur pasqyra fianciare sipas SNRF-ve. Kjo bën, që një numër shoqërish lokale audituese anëtare të rrjeteve të shoqërive audituese ndërkombëtare të japin një ndihmë të konsiderueshme në përgatitjen e pasqyrave fianciare sipas SNRF-ve (referohuni paragrafit 76 më sipër). Problemi i mungesës së kontabilistëve me eksperiencë do të thellohet për njësite ekonomike shqiptare dhe mbështetja e tyre tek audituesit mund të rritet me hyrjen në fuqi të Ligjit për Kontabilitetin (2004).

- ***Njësitë ekonomike do të përballen me vështirësi të konsiderueshme në matjen/vlerësimin e aktiveve dhe detyrimeve në përputhje me SNRF-të.*** Dy shoqëritë e marra si shembull për vëzhgim me investim të huaj të drejpërdrejtë nuk kanë çështje të trashëguara nga e kaluara (psh. vlerësimin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara ku kostoja e blerjes është e pasigurt), megjithatë njësitë ekonomike në Shqipëri përballen me vështirësi të konsiderueshme në vlerësimin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara. Për ato shoqëri që nuk mund të llogarisin vlerën kontabël të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara sipas SNRF-ve, mungesa e vlerësuesve me kualifikime ndërkombëtare të njohura mund të sjellë vështirësi të konsiderueshme në përdorimin e SNRF-ve me kalimin nga PKK në SNRF.

- ***Njohja e saktë e aktiveve dhe detyrimeve është një sfidë për njësitë ekonomike në Shqipëri sipas SNRF-ve***. Shumë njësi ekonomike ende përpiqen të vazhdojnë me mbajtjen e llogarive për paratë (në cash) (në bazë arkëtimesh dhe pagesash) dhe transaksione të ngjashme ose për qëllime raportimi mbajnë dy lloje librash për të shmangur tatimet. Një pjesë e madhe e shoqërive përpiqen

[20] Ne shume raste kopja elektronike e pasqyrave financiare te audituara (qe u morren nga ne ne shqyrtim), na la pak dyshime per autoresine e pergatitjes se pasqyrave, meqenese dokumentat i perkisnin shoqërive lokale të auditimit anëtare të rrjeteve të shoqërive ndërkombëtare.

gjithashtu të mbajnë kontabilitet në bazë të drejtash dhe detyrimeve të konstatuara dhe shënimeve shpjeguese. Ato kanë vështirësi në identifikimin e transaksioneve brenda grupit pasi në të kaluarën ky identifikim ishte i panevojshem për shkak ose të fokusimit të tyre në pasqyrat financiare të njësisë ligjore ose të mungesës së strukturave të grupit.

**78. Pasqyrat financiare të konsoliduara të pesë bankave tregëtare pretendojnë të jenë në përputhje me SNRF-të por të dhënat tregojnë se ka mospërputhje me SNK 21, *Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Këmbimit* në tre banka.** Njëra nga këto banka përdor dollarin amerikan US$ si monedhë matëse (funksionale/të kontabilitetit) një praktikë që është në konflikt me SIC 19, *Monedha e Raportimit—Matja dhe Paraqitja e Pasqyrave Financiare sipas SNK 21 dhe SNK 29.* Dy banka, e trajtojnë kapitalin si një mjet monetar të këmbimit valutor gjë që është në kundërshtim me SNK 21. Përveç këtyre çështjeve, analiza dhe diskutimet me stafin drejtues dhe audituesit nxorrën në pah aspektet e mundëshme ku ka mospërputhje me SNRF-të:

- ***Aktive dhe detyrime të nën apo mbi vlerësuara:*** Një numër pasqyrash financiare të bankave deklarojnë se "mungesa e likuiditetetve/mjeteve monetare në tregun shqiptar e bën të pamundur përcaktimin e vlerës së drejtë të të gjithë aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare." Kështu që, këto banka, konkludojnë pa evidencë mbështetëse se "vlerat e drejta të letrave me vlerë për tregëti dhe investime nuk ndryshojnë materialisht nga vlerat e tyre kontabël." Në mungesë të një përpjekje rigoroze për të vlerësuar vlerën e drejtë, është e pamundur të përcaktohet nëse vlerat janë të arsyeshme.
- ***Përdorimi i masave të kujdesit për të përcaktuar njohjen e aktiveve dhe detyrimeve të pasqyrave fianciare të përgatitura sipas SNRF-ve:*** Aplikimi i SNK 39, *Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja*, mund të deformohet nga kërkesat për kujdes për provizionet në lidhje me humbjet nga huadhënia. Edhe pse shënimet e pasqyrave financiare përcaktojnë qartë se "… për qëllime të matjes së shumave të parashikuara për humbjet nga huadhëniet, shuma e rikuperueshme e huave matet me vlerën aktuale të flukseve të parashikuara/pritëshme të parasë," stafi drejtues i bankave nuk ishte në dijeni të kësaj politike matjeje. Gjithashtu, në disa pasqyra financiare thuhet se "per huatë për të cilat pagesa e këstit është vonuar më shumë se 90 ditë, pezullohet llogaritja e interesave". Kjo mund të jetë në kontradiktë me zbatimin e një politike matjeje të fluksit të zbritur/skontuar të parasë.

**79. Pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërive të sigurimeve pretendohen të jenë në përgatitur përputhje me SNRF-të dhe audituesit me të drejtë kanë shprehur opinion me rezervë për shkak të mospërputhjeve të rëndësishme me SNRF-të dhe kufizimit në zbatueshmëri, duke përfshirë pikat e mëposhtëme:**

- ***Shoqëria nuk bën matjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara në përputhje me SNK 16, Aktivet e Qëndrueshme Të Trupëzuara (AQT).*** Shoqëria ka bërë rivlerësimin e AQT më 31 dhjetor 1997 me koefiçientë dhe jo me vlerën e drejtë (të tregut) siç kërkohet nga SNK 16. Rrjedhimisht, vlera

kontabël e AQT-ve (dhe shpenzimet e lidhura të amortizimit) mund të jenë të mbi apo nën vlerësuara.

- ***Shoqëria nuk ka arritur të rivlerësojë detyrimet e sigurimeve për humbjet, shpenzimet për rregullimin e humbjeve dhe detyrimet e pafituara të primeve të sigurimeve në monedhë të huaja me kursin e këmbimit në datën e mbylljes së bilancit.***
- ***Audituesit nuk kanë arritur të përcaktojnë nëse primet e arkëtuara janë deklaruar saktësisht dhe nuk siguruar të dhëna të mjaftueshme për të vlerësuar disa detyrime sigurimesh.***

Siç është diskutuar në paragrafin 76 më sipër, shumë nga politikat kontabël kanë një formulim standard me fjalë dhe nuk lidhen me ngjarjet dhe transanksionet e trajtuara nga pasqyrat finanicare.

**80. Me përjashtim të sektorit bankar, cilësia e pasqyrave financiare të tjera të përgatitura sipas PKK ishte në përgjithësi e dobët me një sërë rastesh mospërputhjeje.** Siç përmendet më poshtë, këto çështje janë me rëndësi pasi në shumë raste përdoruesit e pasqyrave financiare mund të marrin një vendim të painformuar mbi bazën e tyre, ose më keq, mund të mos marrin informacionin e duhur që ju nevojitet në vendimarrjen e tyre. Këto çështje[21] të vërejtura përfshijnë sa më poshtë:

- ***Edhe pse grupi i përzgjedhur i pasqyrave financiare të bankave në përgjithësi është në përputhje me Manualin e Kontabilitetit për Bankat, të gjitha bankat e kanë mbivlerësuar paranë e tyre dhe ekuivalentet e saj. Gjithashtu, njëra nga bankat përdor dollarin amerikan si monedhë funksionale.*** Të gjitha bankat kishin depozita në Bankën e Shqipërisë (rezerva ligjore) në para dhe ekuivalente të saj. Disa prej tyre, kishin gjithashtu edhe depozita me afat në para dhe ekuivalente të saj. Këto shuma nuk janë shumë likuide. Përfshirja e tyre si pjesë e parave dhe ekuivalenteve të saj mund të paraqesë një pamje të likuiditeteve më të favorshme se ajo që ekziston në të vërtetë.
- ***Të gjitha shoqëritë e sigurimeve të vëzhguara, nuk paraqesin një pasqyrë të fluksit të parasë dhe pasqyrë të ndryshimeve të kapitalit.*** Gjithashtu, njëra prej shoqërive të sigurimeve nuk ka paraqitur pasqyra financiare të konsoliduara. Tre nga katër shoqëritë e sigurimeve nuk kanë dhënë ndonjë informacion që lidhet me politikën e kontabilitetit dhe përbërjen e primeve të tyre rë sigurimeve, detyrimeve dhe rezervave teknike. Këto mangësi janë të tilla që mund të pengojnë një lexues të pasqyrave financiare në nxjerrjen e ndonjë konkluzioni në lidhje bazën e përgatitjes së tyre apo në lidhje me gjendjen financiare të shoqërisë.
- ***Pasqyrat financiare të sektorit të njësive ekonomike janë të paqarta në përgjithësi.*** Mes 11 pasqyrave fianciare të përzgjedhura, katër prej tyre përfshinin më shumë deklarata tatimore sesa pasqyra financiare të përgatitura në

[21] Grupi i ROSC-ut vendosi të raportojë vetëm mbi ato probleme të cilat u mendua se ishin të rëndësishme dhe për të cilat nuk do të kishim dyshime. Për këtë arsye, disa probleme mospërputhshmërie nuk janë përfshirë në raport, sepse grupi i punës së ROSC-ut e kishte të vështirë të arrinte në përfundime të sigurta për natyrën dhe mos përputhshmërine e tyre.

përputhje me PKK (ose Manualin e Kontabilitetit për Bankat në rastet e bankave) dhe dy prej tyre përdornin kontabilitetin në bazë të arkëtimeve dhe pagesave.

## IV. STANDARDET E AUDITIMIT TË HARTUARA DHE TË VËNA NË PRAKTIKË

**81. Standartet e Auditimit të përdoruara në Shqipëri janë SNA-të dhe burimet e përdorura për përkthimin e SNA-ve, duket se janë në një nivel mjaft të avancuar në krahasim më nivelin e kuptueshmërisë dhe përdorimit të SNA-ve.** Problemet e identifikuara në praktikën e SNA-ve janë të një niveli shumë më të ulët Për shembull, problemet që lidhen me pavarësinë e audituesve, objektivën e një auditimi, vlerësimin e rrezikut të auditimit, procedurat bazë të auditimit dhe probleme të tjera të këtij lloji janë vënë re. Sfida kryesore për Shqipërinë, qëndron në kualifikimin mbi SNA-të dhe nxitjen e zbatimit të parimeve bazë të dhëna në këto standarde.

**82. Diferencat në aftësitë teknike, nivelin e eksperiencës dhe nivelin e burimeve në shoqëri të ndryshme të auditimit sjellin dallime në cilësinë e auditimit.** Analiza e pasqyrave financiare të audituara identifkon çështje specifike të cilat kanë ndikim negativ në cilësinë e praktikave të auditimit në Shqipëri:

- ***Kontrollet e pamjaftuesheme dhe jo të vijueshme të cilësisë së shoqërive të auditimit.*** Ndonëse disa shoqëri auditimi anëtare të rrjeteve të shoqërive ndërkombëtare të auditimit me një përfaqësi direkte përfitojnë nga proçedurat e kontrollit të brendshëm të cilësisë në mbarë shoqëritë, shoqëri tjera kanë një mbështetje të kufizuar në këtë aspekt. Çështjet shqetësuese mbi auditimin e pasqyrave financiare (duke përfshirë pasqyrat financiare sipas SNRF-ve) të kryer nga shoqëritë anëtare të rrjeteve të shoqërive ndërkombëtare të auditimit përfshijnë:
  - Mospërputhjen me Kodin e Etikës së IFAC për Kontabilistët Profesionistë, sidomos, seksionin 8, *Pavarësinë.* Kjo është diskutuar në paragrafin 39 më lart.
  - Mospërputhjen me SNA 240, *Përgjegjësia e Audituesit për të trajtuar Mashtrimet në Pasqyrat Fianciare*. Nga vëzhgimi, u vu re se disa shoqëri lokale auditimi anëtare të rrjeteve të shoqërive ndërkombëtare të auditimit nuk kryejnë sistematikisht procedurat e kërkuara sipas SNA 240 ndonëse standardi duket të lidhet më shumë me një mjedis ku mashtrimet tatimore janë të përhapura. Ky konkluzion, u arrit në bazë të deklaratave të drejtëpërdrejta të shoqërive lokale të auditimit anëtare të rrjetit të shoqërive ndërkombëtare të auditimit si dhe nga rishikimi/kontrolli i shoqërive të auditimit i kryer nga Banka Botërore për qëllime besueshmërie.
- ***Një numër i konsiderueshëm raportesh auditimi të përgatitura nga shoqëri lokale auditimi ishin shumë të dobëta dhe nuk bënin të mundur që përdoruesit e këtyre pasqyrave financiare të nxirrnin ndonjë konkluzion mbi***

***punën e ndërmarrë nga shoqëria e auditimit.*** Këtu përfshihen çështjet e mëposhtëme:

- Në bazë të rishikimit të pasqyrave financiare, 10 nga 19 pasqyrat financiare të audituara nga shoqëri lokale auditimit ishin pa asnjë dyshim të përgatitura nga auditues. Konfuzioni në lidhje me rolin e audituesit është ilustruar në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të "rregullimeve/përshtatjeve të auditimit" të cilat nuk ishin rregjistruar.
- Përsëri, 4 nga 19 raportet e auditimi përmbanin një opinion auditimi mbi deklaratat tatimore në vend të opinionit mbi pasqyrat financiare, gjë që dëshmon mungesën e të kuptuarit të objektivës së auditimit nga ana e auditorëve (dhe stafit drejtues).

Industria e sigurimeve dhe specialistët janë në një fazë fillestare të zhvillimit. Në testimin e plotësisë dhe saktësisë së rezervimit të dëmeve, del në pah se shoqëritë e auditimit nuk janë më të avancuar se shoqëritë e sigurimeve të cilët ata auditojnë.

## V. KËNDVËSHTRIMI MBI CILËSINË E RAPORTIMIT FINANCIAR

**83. Ekziston një opinion i përgjithshëm se me përjashtim të bankave, njësitë e tjera ekonomike përgatisin pasqyra financiare me cilësi të dobët.** Cilësia më e lartë e pasqyrave financiare të përgatitura nga bankat është falë monitorimit më të afërt dhe nxitjes për zbatim nga ana e Bankës së Shqipërisë, kufizimit të shoqërive të auditimit që lejohen të kryejnë auditimin e bankave dhe aftësisë së bankave për të tërhequr profesionistë me kualifikim të lartë. Nga ana tjetër, cilësia e dobët e pasqyrave financiare të përgatitura nga njësitë e tjera, në përgjithësi vjen nga kërkesa e kufizuar për informacion financiar nga palët e treta, dominimi i raportimit për qëllime tatimore në mungesë të qëllimeve të tjera, nxitja e kufizuar për zbatim nga autoritetet përkatëse dhe aftësitë e kufizuara të kontabilistëve dhe audituesve.

**84. Në dhënien e kredive, bankat nuk iu besojnë shumë pasqyrave financiare të paraqitura nga huamarrës potencialë.** Ndonëse njësitë ekonomike kërkohen të përgatisin pasqyrat e tyre financiare si pjesë e procesit të aplikimit për huamarrje, bankat në përgjithësi i marrin vendimet e tyre për huadhënie duke u bazuar në faktorë të tjerë siç janë shuma e kolateralit, parashikimet e ecurisë së biznesit dhe vizitat që ata vetë kryejnë pranë njësive ekonomike.

## VI. REKOMANDIME MBI POLITIKAT

**85. Rekomandimet e ROSC janë të ndërlidhura dhe mbështesin njëra-tjetrën në mënyrë të ndërsjelltë dhe kanë për qëllim të përmirësojnë gjendjen e raportimit financiar në Shqipëri.** Këto rekomadime, të cilat shpjegohen në seksionet e mëposhtëm dhe në figurën 1, ndahen në gjashtë boshte/grupe kryesore të infrastrukturës së kontabilitetit dhe auditimit. Në shumë raste, reformat në çdo bosht duhet të realizohen në mënyrë paralele pasi të gjashtë boshtet ndërlidhen me njëra-tjetrën. Për shembull, forcimi procesit të hartimit të standardeve pa një forcim e përmirësim të mekanizmave të monitorimit dhe zbatimit nuk do të bënte të mundur zgjidhjen e çështjes së mospërputhshmërisë me standardet e kontabilitetit. Për sa i takon prioritetit, vëmendje e veçantë i duhet kushtuar

forcimit të kapaciteteve teknike në të gjitha boshtet. Figura 1, jep një përmbledhje të thjeshtuar të rekomandimeve kyçe dhe afateve kohore të sugjeruara për zbatim. Faktorët e rëndësishëm të suksesit për zbatim përfshijnë udhëheqjen nga nivelet e larta të qeverisë, kapitalizimin e dëshirës aktuale për ndryshim dhe ekuilibrimin e stimujve dhe kundërstimujve për përputhshmërinë me kërkesat e raportimit financiar.

**86. Përkatësisht, rekomandohet <u>forcimin e kuadrit ligjor/statutor</u> që udhëheq kontabilitetin, auditimin dhe raportimin financiar duke përdorur një metodë holistike dhe duke marrë parasysh edhe ligje e rregullore të tjera, si Ligjin për Shoqëritë Tregëtare, Ligjin Për Tatimet etj.** Rekomandohet që të ngrihet një grup multi-dispilinar i cili do të ndërmarrë sa më poshtë:

- Një rishikim të plotë të të gjithë legjislacioneve që lidhen me kontabilitetin, auditimin dhe raportimin financiar me qëllim që të identifikohen kërkesat e paplota/paqarta apo konfliktuale, duke përfshirë edhe ato që lidhen me konsolidimin, standardet e zbatueshme të kontabilitetit për ndërmjetues fianciarë jo-bankarë dhe institucionet e mikrofinancës.
- Hartimin e një ligji për auditimin në përputhje me Direktivën e Tetë të BE-së për Shoqëritë Tregëtare për të përfshirë por jo duke u kufizuar në krijimin e një sistemi të mbikëqyrjes publike të profesionit të auditimit, një kontroll të lartë të cilësisë së auditimeve ligjore, dhe rregulla mbi regjistrimin e auditorëve vendas e të huaj, duke përfshirë firmat e auditimit.
- Vendosjen e kufijve të përshtatshëm për kërkesat e thjeshtuara të raportimit financiar dhe përjashtimin nga auditimi ligjor vjetor duke përfshirë kriteret e përdorura për përcaktimin e njësive ekonomike të rëndësishme nga pikëmaja ekonomike. Kjo do të shmangë mbinkarkimin e SME-ve me kërkesa të tepërta mbi raportimin financiar dhe auditimin. Nga ana tjetër, do të sigurohej që *njësitë ekonomike me interest për publikun* i nënshtrohen një transparence më të madhe dhe kërkesave më të forta për shpjegime. Kjo duhet bërë nëpërmjet një analize të strukturës së biznesit në Shqipëri.
- Të kërkohet që *njësitë ekonomike me interes publik* të paraqesin për publikun pasqyrat e tyre financiare të njësisë ligjore dhe ato të konsoliduara brenda një periudhe të arsyeshme kohe pas datës së bilancit.
- Harmonizimin e kuadrit tatimor me legjislacionit për kontabilitetin, auditimin dhe raportimin financiar. SNRF-të dhe SKK-të do të prezantojnë kategori të reja të ardhurash dhe shpenzimesh, kështu që do të nevojiten udhëzime mbi rakordimin/përputhjen e fitimit/humbjes kontabël me fitimin/humbjen e tatueshme. Në kushet e mungesës së udhëzimeve të tilla, njësitë ekonomke do të ngatërronin standardet tatimore dhe ato të kontabilietit në përgatitjen e pasqyrave financiare.

.

**87. Rekomandohet që struktura e hartimit dhe vendosjes së <u>standardeve të kontabilitetit të forcohet dhe të bëhet e qëndrueshme</u>.** Kjo do të kërkonte:

- Zgjerimin e organit aktual të vendosjes/hartimit të standardeve për të përfshirë një shkallë më të gjerë të palëve të interesuara me qëllim që të trajtohen dhe

plotësohen sistematikisht nevojat e pjesëmarrësve nga sektori privat dhe publik në procesin e hartimit të standardeve duke përfshirë edhe përshtatshmërinë e qëllimit/fushës së zbatimit të SNRF-ve dhe SKK-ve, që nënkupton kërkesa të thjeshta raportimi për SME-të dhe kërkesa raportimi më rigoroze për *njësitë ekonomike me interes publik.*

- Mobilizimin e financimit dhe ekspertizës teknike për të siguruar që standardet e kontabilitetit janë bashkëkohore (të përditësuara).
- Dokumentimin, përhapjen dhe zbatimin e një strategjie të qartë për hartimin dhe adoptimin e standardeve e cila përfshin një proces efikas konsultimi. Kjo do të ndihmojë në zgjidhjen e problemit të nivelit e ulët aktual të demonstruar të njohjes dhe zbatimit të standardeve të kontabilitetit.
- Kërkimin dhe gjetjen e sinergjive/bashkëpunimeve për përkthimin e standardeve të kontabilitetit dhe auditimit në përputhje me politikat e përkthimit të Fondacioneve të Komitetit Ndërkombëtar të Standardeve të Kontabilitetit (IASCF) dhe IFAC. KKK duhet të kërkojë mundësi për të bashkëpunuar me organin e hartimit/vendosjes së standardeve të auditimit, duke përfshirë grupimin e burimeve dhe përdorimin e një programi (software) të përbashkët.

- Angazhimin e rregullatorëve të bankës dhe sigurimeve në forume ndërkombëtare për të parë/studiuar lidhjet mes raportimit për qëllime të kujdesit dhe raportimit financiar për qëllime të përgjithshme në mënyrë që të krijohen filtra kujdesi. Kjo do të mund të zgjidhte shqetësimin e rregullatorëve se zbatimi i SNRF-ve mund të rrezikojë kriteret rregullatore të fondeve të veta dhe të sjellë një paqëndrueshmëri në pasqyrat financiare. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë duhet të marrë në konsideratë (i) udhëzimet mbi një kuadër të përbashkët raportimi financiar (COREP)[22] që do të përdoret nga institucionet kredidhënëse dhe shoqëritë e investimeve në raportimin e tyre mbi aftësinë financiare pranë autoriteteve mbikëqyrëse sipas Direktivës për Kërkesat Mbi Kapitalin dhe (ii) udhëzimet mbi një kuadër të standardizuar raportimi financiar (FINREP) për institucionet kredidhënëse që operojnë në BE. Ky kuadër bën të mundur që institucionet kredidhënëse të përdorin të njëjtat formate të dhënash dhe përkufizime të dhënash për raportim për qëllime kujdesi në të gjitha vendet ku zbatohet kuadri, duke zvogëluar ngarkesën e raportimit për insitucionet kredidhënëse që operojnë jashtë vendit, dhe duke ulur pengesat për zhvillimin e një tregu efikas të shërbimeve financiare. Kjo ka një rëndësi të veçantë sidomos në kontekstin aktual të vendit, ku një pjesë e mirë e sektorit bankar është nën pronësi të huaj.

**88. Rekomandohet të krijohet një strukturë e qëndrueshme për <u>vendosjen/hartimin e standardeve të auditimit</u>.** Për këtë do të duhej:

- Krijimi i një procesi të qëndrueshëm për hartimin/vendosjen e standardeve të auditimit, që siguron përkthimin e SNA-ve dhe zhvillimin e praktikave relevante të auditimit, veçanërisht për SME-të.

[22] Udhezimet mund te gjenden ne http. ;www.c-ebs.org /standard.htm

- Mobilizimi i fondeve dhe ekspertizës teknike për të siguruar përkthimin në kohë të SNA-ve. Kjo do të përfshinte gjetjen dhe shfrytëzimin e sinergjive/bashkëpunimeve për përkthimin e SNRF-ve.

**89. Rekomandohet të krijohen mekanizma sistematike të institucionalizuara <u>të monitorimit dhe zbatimit</u> për të siguruar përputhshmërinë me standardet e kontabilitetit dhe auditimit.** Për këtë do të duhej:

- Përditësimi i legjislacionit për të përcaktuar qartë autoritetin e organeve që nxisin vënien në zbatim të standardeve të kontabilitetit dhe auditimit dhe për të modernizuar sanksionet ekzistuese me qëllim që ata të bëhen parandalues më të mirë. Shqipëria mund të marrë në konsideratë parimet e zbatimit të standardeve të kontabilitetit të përcaktuara nga Komiteti i Rregullatorëve Evropianë të Letrave me Vlerë edhe pse ato janë zhvilluar në kontekstin e shoqërive të listuara. Raportet e auditimit me rezerva duhet të inkurajonjë investigimet mbi njësitë ekonomike dhe raporet e auditimit pa rezerva të cilat në fakt duhet të kishin nxitur një opinion me rezervë, duhet të çojnë gjithashtu në investigimin e një shoqërie audituese.
- Krjimi i një sistemi të kontrollit të cilësisë i cili i nënshtrohet mbikëqyrjes së publikut. Kontrolli i cilësisë për auditimin ligjor është shumë i rëndësishëm për të siguruar një cilësi të mirë auditimi e cila rrit besueshmërinë e informacionit financiar të publikuar dhe iu jep vlerë e mbrojtje aksionerëve, investuesve, kreditorëve dhe palëve të tjera të interesuara. Sistemi mund të mbështet mbi praktikat ekzistuese të Vendeve Anëtare të BE-së, sidomos atyre vendeve që janë bërë anëtare të BE-së në 1 maj 2004, të cilave iu është dashur të zbatojnë sisteme të sigurimit të cilësisë në rrethana të ngjashme edhe pse jo identike me ato të Shqipërisë. Gjithashtu, SMO 1 i IFAC, *Kontrolli i Cilësisë*, është një udhëzues i dobishëm për këtë qëllim. Rezultatet e sistemit të kontrollit të jashtëm të cilësisë së auditimit duhet të përfshihen në programin e Zhvillimit Profesional të Vijueshëm dhe/ose sistemin disiplinar sipas rastit.
- Kërkesës ndaj auditorëve ligjorë dhe shoqërive të auditimit që kryejnë auditime ligjore *të njësive me interes publik* për të përgatitur dhe publikuar raporte vjetore të transparencës. Këto raporte duhet të përfshijnë një përshkrim të rrjetit dhe organizimeve strukturore dhe ligjore të saj në rastet kur shoqëria audituese është pjesë e një rrjeti; informacion mbi strukturën qeverisëse të shoqërisë audituese; një përshkrim të sistemit të kontrollit të brendshëm të cilësisë; një listë *të njësive ekonomike me interes publik* që janë audituar nga shoqëria audituese në vite; dhe informacion tjetër të rëndësishëm që do të ndihmonte përdoruesit e pasqyrave financiare për të rritur besimin në cilësinë e punës së auditimit
- Ngritjen e një sistemi efikas investigimesh dhe sanksionesh për të zbuluar, korrigjuar dhe parandaluar kryerjen e pamjaftueshme të auditimit ligjor. Sistemi mund sigurojë vendosjen e gjobave efikase, proporcionale dhe parandaluese civile, administrative apo penale për auditues dhe shoqëri të auditimit ligjor, në rastet kur auditimet ligjore nuk kryhen në përputhje me Ligjin Për Auditimin, SNA-të dhe/ose Kodin e Etikës Për Kontabilistët Profesionistë. Gjithashtu, çdo masë apo sanksion i vendosur ndaj audituesve apo shoqërive të auditimit ligjor, duhet të bëhet e ditur për publikun. Sistemi i kontrollit të cilësisë, mund të ngrihet mbi bazën e praktikave ekzistuese në Vendet Anëtare të BE-së. SMO 6

të IFAC, *Investigimi dhe Disiplina*, është gjithashtu një udhëzues i dobishëm për këtë qëllim.

- Marrjen e stafit të mjaftueshëm në numër dhe rritjen e ekspertizës së organeve përgjegjëse për monitorimin dhe nxitjen e zbatueshmërisë. Kontrolluesit duhet të kenë ekspertizë në rishikimin/kontrollin e pasqyrave financiare për të përcaktuar nëse ato janë në përputhje me standardet e kontabilitetit. Po kështu, kontrolluesit e shoqërive të auditimit duhet të kenë aftësinë për të vlerësuar nëse mekanizmat e kontrollit të brendshëm brenda shoqërive janë efikase dhe të mjaftueshme për të siguruar kryerjen e auditimeve cilësore.
- Përmirësimi i rregjistrit të audituesve dhe shoqërive të auditimit ligjor me qëllim që palët e interesuara të mund të përcaktojnë me lehtësi nëse një auditues është i miratuar/licensuar apo jo, etj. Kjo do të bëhet e mundur nëpërmjet regjistrimit në një rregjistër elektronik publik. Disponueshmëria e rregjistrit publik në gjuhë të huaj do të rriste ndjeshëm dobishmërinë e tij në kontekstin e investimeve të huaja direkte apo të portofolit.

**90. Rekomandohet që profesionalizmi dhe cilësia e punës <u>së profesionistëve të kontabilitetit dhe auditimit të përmirësohen</u>.** Kjo do të arrihej nëpërmjet:

- Qartësimit të mandatit të IEKA-s për të përfshirë shërbimin për interesin e publikut.
- Heqjen e përcaktimit të çmimit të auditimit nga qeveria, gjë e cila aktualisht e kufizon spektrin dhe cilësinë e punës së audituesve. Më shumë besim i duhet kushtuar procesit të kontrollit të cilësisë, investigimit dhe disiplinës për të monitoruar pavarësinë e audituesve dhe cilësinë e auditimit.
- Kërkimit të anëtarësimit (të plotë) në organizatat ndërkombëtare të tilla si IFAC dhe me kalimin e kohës, në Federatën Evropiane të Kontabilistëve. Anëtarësimi në këto organizata ndërkombëtare shpesh siguron disiplinën dhe strukturën që ndihmon organizatat profesionale lokale t'iu përmbahen standardeve minimale e cila ndihmon në përmirësim.
- Qartësimin e rolit dhe përgjegjësive të Kontabilistëve të Miratuar dhe të konsiderohet merita e një përforcimi të rregullatiorëve.

**91. Në lidhje me <u>arsimimin dhe kualifikimin,</u> rekomandohet rritja e numrit të profesionistëve të kontabilitetit dhe auditimit të aftë për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe për kryerjen e auditimeve cilësore përkatësisht. Gjithashtu, duhen ndërmarrë nisma për tërheqjen e të sapodiplomuarave më të mirë në profesion dhe për rritjen e njohjes së kualifikimeve në kontabilitet dhe në auditim të organizuara në Shqipëri.** Kjo do të kërkonte:

- Rishikimin e kurrikulës/programit mësimor të universitetit për të përfshirë më shumë materiale nga SNRF-të, SNA-të, etika e biznesit dhe drejtimin e koorporatës.

- Dhënien e stimujve për individët për përfshirjen e tyre në profesion. Stimujt mund të jenë në formën e bursave nga qeveria dhe njësitë e biznesit për të studiuar kontabilitet.
- Përditësimit të standardeve të kualifikimit në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Arsimimit (IES) të IFAC. Kjo do të përfshinte përmirësimin dhe përditësimin e programit të provimeve profesionale, përmbajtjes së provimeve dhe vlerësimin e tyre me qëllim që të përfshihen aspekte të rëndësishme të cilat aktualisht nuk janë të përfshira. Kjo do të sigurontë profesionistë më të kualifikuar dhe njohje më të mirë të kualifikimeve. Për shkak të mungesës së burimeve në vend, duhet të kërkohen sinergji ndërmjet arsimimit dhe kualifikimit të kontabilistëve dhe audituesve.
- Koordinimit dhe organizimit të kurseve të trainimit, veçanërisht në aspektet e SNRF-ve dhe SNA-ve, të drejtuara nga ekspertë rajonalë apo ndërkombëtarë. Kurset e trainimeve duhet të jenë duke filluar nga niveli bazë i njohurive në atë më të avancuarin. Përveç kësaj, kurse duhet të jepen edhe për fusha të specializuara si raportimi financiar dhe auditimi i bankave dhe shoqërive të sigurimeve.
- Monitorimit sistematik të anëtarëve për të parë përputhshmërinë me CPD dhe marrjen në konsideratë të pezullimit të liçensave të anëtarëve në raste shkeljesh.
- Ngritjes së një qendre arsimore profesionale kontabiliteti për të siguruar trainim bashkëkohor në kontabilitet, auditim, raportim financiar dhe aspekte të tjera të lidhura me këto.
- Vendosjes apo ri-vendosjes si lidhjeve/marrëdhënieve me organizatat ndërkombëtare profesionale të kontabilitetit.